



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 106

Tiranë – E mërkurë, 24 qershor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5, datë 27.5.2015	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 28.1.2009 “Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”..... 5685
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 6, datë 27.5.2015	Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifat e shërbimit..... 5690



UDHËZIM

Nr. 5, datë 27.5.2015

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 1, DATË 28.1.2009 “PËR
PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E
KOMPETENCËS PROFESIONALE TË
DREJTUESIT TË VEPRIMTARISË SË
OPERATORIT TË TRANSPORTIT
RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; nenit 6 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; pikave 6, 7 dhe 8 të kapitullit II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 19.3.2008, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Neni 1

1. Shkronja “d” e nenit 7, riformulohet si vijon:

“d) Përfshihen nga provimi, por jo nga trajnimi, kandidatët të cilët rinovojnë certifikatën e kompetencës profesionale

Neni 2

2. Pas nenit 7, shtohet neni 7/1, me përmbajtjen si vijon:

“Neni 7/1

Trajnimi i reduktuar

a) Mbajtësi i një certifikate të kompetencës profesionale (CKP), së cilës i ka përfunduar afati i vlefshmërisë, dhe vërteton se ka ushtruar veprimtarinë e tij pa ndërprerje në tre vjetët e fundit, i nënshtrohet trajnimit të reduktuar prej 24 orë, të ndarë në seanca me nga 6 orë secila.

b) Mbajtësi i certifikatës të kompetencës profesionale (CKP), së cilës i ka përfunduar afati i vlefshmërisë, por nuk vërteton se ka ushtruar për 3 vjetët e fundit veprimtarinë e tij pa ndërprerje, i nënshtrohet trajnimit të reduktuar prej 48 orë, të ndarë në seanca me nga 6 orë secila.

c) Programi dhe modulet e trajnimit të reduktuar për shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni hartohen nga DPSHTRr-ja sipas shtojcës 1 dhe miratohen nga ministri. Programet dhe modulet e trajnimit ndërtohen mbi bazën e zhvillimeve të reja të teknologjisë së transportit rrugor.

ç) Pas trajnimit të reduktuar, lëshohet certifikata e kompetencës profesionale me afat 5 vjet”.

Neni 3

Shtojca 2 riformulohet si më poshtë, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

**Modeli A1**

Format A4 (294 x 210)

Pesha: 150 g/ m²

Ngjyra: e verdhë e fortë

SHTOJCA Nr.2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AL

Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor

ÇERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN
RRUGOR BRENDA VENDIT TË UDHËTARËVE

Nr. _____

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj vërteton që:

(a)

Emri mbiemri: _____

Vendi i lindjes: _____

Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/ ¹)
 organizuar për dhënien e çertifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor brenda vendit të udhëtarëve në përputhje me udhëzimin nr.1, datë 28/01/2009 "*Për çertifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor*".

(b) personi i përmendur në pikën (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi profesionale në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor të udhëtarëve:

duke u angazhuar vetëm në transportin brenda vendit,

Kjo çertifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave/ udhëtarëve në transportin kombëtar referuar VKM nr.325, datë 19.3.2008 "*Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë*".

Lëshuar në....., më

E vlefshme deri më:.....

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

¹ në rastin kur aplikohet sipas shkronjave "b", "c", dhe "d" të nenit 7, të udhëzimit.

**Modeli A2**

Format A4 (294 x 210)
Pesha: 150 g/ m²
Ngjyra: e verdhë e fortë

SHTOJCA Nr.2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AL

Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor

ÇERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN RRUGOR
BRENDË VENDIT TË MALLRAVE

Nr.

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj vërteton që:

(a)

Emri mbiemri: _____

Vendi i lindjes: _____

Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/ ¹)
organizuar për dhënien e certifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor
brenda vendit të mallrave në përputhje me udhëzimin nr.1, datë 28/01/2009 “Për
certifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të
transportit rrugor”.

(b) personi i përmendur në pikën (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi profesionale
në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor të mallrave:

duke u angazhuar vetëm në transportin brenda vendit,

Kjo certifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale për pranimin
në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave/ udhëtarëve në transportin
kombëtar referuar VKM nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin
në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për
njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”.

Lëshuar në....., më

E vlefshme deri më:.....

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

¹ në rastin kur aplikohet sipas shkronjave “b”, “c”, dhe “d” të nenit 7, të udhëzimit..

**Modeli A2**

Format A4 (294 x 210)

Pesha: 150 g/m²

Ngjyra: e verdhë e fortë

SHTOJCA Nr.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

AL

Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor

ÇERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN RRUGOR
NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE

Nr. _____

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj vërteton që:

(a)

Emri mbiemri: _____

Vendi i lindjes: _____

Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/ ¹:)
 organizuar për dhënien e certifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor
 të brendshëm të udhëtarëve në përputhje me udhëzimin nr.1, datë 28/01/2009 “Për
 certifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të
 transportit rrugor”.

(b) personi i përmendur në pikën (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi
 profesionale në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor
 ndërkombëtar² të udhëtarëve.

Kjo certifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale për pranimin
 në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave/ udhëtarëve në transportin
 kombëtar referuar VKM nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin
 në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për
 njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”.

Lëshuar në....., më

E vlefshme deri më:.....

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

¹ në rastin kur aplikohet sipas shkronjave “b”, “c”, dhe “d” të nenit 7, të udhëzimit.

² Kjo certifikatë shërben edhe për transportin brenda vendit

**Modeli A2**

Format A4 (294 x 210)

Pesha: 150 g/m²

Ngjyra: e verdhë e fortë

SHTOJCA Nr.2**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS****AL****Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor****ÇERTIFIKATA E KOMPETENCËS PROFESIONALE NË TRANSPORTIN RRUGOR
NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE****Nr.**

Komisioni i vlerësimit të provimit, nëpërmjet kësaj vërteton që:

(a)

Emri mbiemri: _____

Vendi i lindjes: _____

Data e lindjes: _____

ka kaluar testet e provimit (viti:.....; kursi/: ¹.....)
organizuar për dhënien e certifikatës së kompetencës profesionale në transportin rrugor
të brendshëm të mallrave në përputhje me udhëzimin nr.1, datë 28/01/2009 “Për
çertifikatën e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë së operatorit të
transportit rrugor”.

(b) personi i përmendur në pikën (a) është kualifikuar për të punuar me aftësi
profesionale në një ndërmarrje si drejtues veprimtarie për transportin rrugor
ndërkombëtar² të mallrave.

Kjo certifikatë përbën provën e mjaftueshme të kompetencës profesionale referuar VKM-
së nr. 325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e
operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e
dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”

Lëshuar në....., më

E vlefshme deri më:.....

Firma e kryetarit të komisionit

Firma dhe vula e DPSHTRr-së

¹ në rastin kur aplikohet sipas shkronjave “b”, “c”, dhe “d” të nenit 7, të udhëzimit.² Kjo certifikatë shërben edhe për transportin brenda vendit

**UDHËZIM****Nr. 6, datë 27.5.2015****PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT
TË MJETEVE, LËSHIMIT TË
CERTIFIKATËS SË MIRATIMIT ADR,
KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË
PERSONI JURIDIK PËR INSPEKTIMIN
E MJETEVE ADR DHE TARIFAT E
SHËRBIMIT**

Në mbështetje të: nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; pjesës 9 të ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)” dhe protokollin e nënshkrimit”; të neneve 37, pikat 5 dhe 6 dhe 63, të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave e të rrezikshme”, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:**KREU I****1. Qëllimi**

1.1. Qëllimi i këtij udhëzimi është implemtimi i Marrëveshjes Europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme” (ADR), direktivës 2008/68 “Mbi transportin e brendshëm të mallrave të rrezikshme” dhe ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave e të rrezikshme”.

1.2. Me anën e këtij udhëzimi përcaktohen procedurat e inspektimit të mjeteve dhe të lëshimit të certifikatës së miratimit ADR nga trupa inspektuese, kushtet që duhet të plotësoj trupa inspektuese për lëshimin e licencës nga ministri dhe tarifën për inspektimin e mjeteve.

2. Fusha e zbatimit

2.1. Ky udhëzim do të zbatohet për mjetet e transportit rrugor, të mallrave, të kategorive “N” dhe “O”.

2.2. Ky udhëzim është i vlefshëm vetëm për mjetet që kryejnë transport rrugor, ndërkombëtar e të brendshëm të mallrave të rrezikshme.

2.3 Ky udhëzim nuk zbatohet për transportin e mallrave me mjete:

a) që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë; ose

b) që operojnë brenda perimetrit të një zone të mbyllur, ku mallrat mund të prodhohen, trajtohen përpunohen, ruhen, sistemohen apo transferohen në hapësirën e brendshme.

2.4 Në aneksin 1, të shtojcës II, të këtij udhëzimi janë dhënë klasat e ADR dhe llojet e mjeteve në korrespondencë me përshkrimin e mallrave që transportohen.

3. Përkufizime

3.1 Për qëllime të këtij udhëzimi do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) “ADR” nënkupton anekset A dhe B të Marrëveshjes Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme, të rishikuar ose ribotuar, herë pas here;

b) “Direktiva 2008/68” nënkupton direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës e 24 shtatorit 2008 “Mbi transportin e brendshëm të mallrave të rrezikshme”;

c) “Certifikata e miratimit ADR” nënkupton certifikatën e miratimit, në modelin e paraqitur në seksionin 9.1.3.5 të ADR dhe/ose anekset 5 dhe 6, e lëshuar sipas kreut III të këtij udhëzimi;

ç) “Dita e caktuar” nënkupton ditën e caktuar për kryerjen e inspektimit të mjetit ADR;

d) “Inspektori teknik, i autorizuar” nënkupton personin e një trupë inspektuese ADR që kryhen të gjithë ose pjesë të aspekteve teknike të inspektimit të një mjeti ADR;

dh) “Inspektimi ADR i mjetit” nënkupton procesin për kryerjen e inspektimit të detyrueshëm (përfshin testimin që e shoqëron) të mjeteve rrugore ADR sipas kërkesave të përshkruara dhe për përcaktimin e konformitetit të mjeteve të inspektuara te ato kërkesa, në bazë të një gjykimi profesional;

e) “Kontrolli teknik i mjeteve rrugore (KTV)” nënkupton kontrollin teknik vjetor të mjeteve rrugore të kryer sipas udhëzimit nr.2, datë 11.3.2010 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve” të ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

ë) “Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme” nënkupton ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, i cili ka për qëllim rritjen e sigurisë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme;

f) “Miratimi i tipit të mjetit” nënkupton çdo mjet i cili është miratuar në përputhje me rregulloren ECE 105 ose direktivën 98/91/EC;

g) “Mjet-cisternë” nënkupton konstruksionin e një mjeti për transportin e lëngjeve, gazeve ose



substancave pudër ose të granular dhe përmban një ose më shumë cisterna fikse. Përveç mjetit në vetvete, ose njërive të platformave mbajtëse në vend të tij, një mjet-cisternë përmban një ose më shumë mbështjellëse (*shell*), artikujt e tyre të pajisjeve ose elementeve për bashkimin me mjetin ose me njësitë e platformave mbajtëse;

gj) “Mjet i plotë” nënkupton çdo mjet i cili nuk kërkon plotësime të mëtejshme konstruktive (d.m.th. një fazë e ndërtimit të kamionit tërheqësit, rimorkios);

h) “Mjet jo i plotë” nënkupton çdo mjet i cili ka nevojë për plotësime konstruktive në një fazë të mëtejshme (d.m.th. shasi – kabinë, shasi – rimorkio);

j) Mjet i plotësuar” nënkupton çdo mjet i cili është rezultat i një procesi shumë-fazësh (d.m.th. i përshtatur me një strukturë të jashtme shasi ose shasi –kabinë);

k) “Pronar i mjetit” nënkupton personin në emër të të cilit mjeti është i regjistruar dhe, për sa i përket një mjeti i cili është subjekt i blerjes me këste ose sipas një marrëveshje me leasing, nënkupton personin në zotërim të mjetit sipas një marrëveshje të tillë;

l) “Qendra e inspektimit ADR të mjetit” nënkupton lehtësirat (d.m.th. ndërtesën, dhe njësitë lëvizëse të përdorura nga një trupë inspektuese për kryerjen e inspektimeve të mjetit;

m) “Riinspektim” nënkupton inspektimin pasues të mjetit sipas kreut III të këtij udhëzimi, në vijim të refuzimit të certifikatës së miratimit të këtij mjeti, ku riinspektimi teknik kryhet brenda 14 ditëve pas ditës në të cilën certifikata e miratimit të mjetit është refuzuar;

n) “Trupa inspektuese” nënkupton personin juridik të autorizuar dhe të vëzhguar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

KREU II

Personi juridik për pranimin dhe shqyrtimin e dokumenteve të mjeteve

4. Caktimi i personit juridik dhe i inspektuesit teknik të autorizuar

4.1 a) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) autorizohet si autoritet përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit për sa i përket mjeteve që transportojnë disa mallra të rrezikshme dhe, ka në përbërje të saj personel të trajnuar ose ka të drejtën e

trajnimit të personelit.

b) Autorizimi, si autoritet përgjegjës sipas shkronjës “a” të kësaj pike, mund të pezullohet apo shfuqizohet nga ministri.

4.2 Autoriteti përgjegjës mund të caktoj një person (ose persona), i cili është një inspektor teknik, i autorizuar ADR për vëzhgimin e qendrave të inspektimit sipas pikës 21.

5. Regjistri i personelit të trajnuar

5.1 a) Autoriteti përgjegjës cakton një ose disa punonjës, për krijimin e regjistrit të personave (“regjistri i personelit të trajnuar”), të cilët i janë nënshtruar kurseve të miratuara të trajnimit për qëllime të shqyrtimit që një mjet është në përputhje me kërkesat e pjesës 9, të ADR dhe/ose anekseve 11 dhe 12, të shtojcës I, të këtij udhëzimi.

b) Një kurs trajnimi i miratuar është një kurs i rekomanduar, i mbikëqyrur ose i miratuar nga autoriteti përgjegjës sipas pikës 5.1, të këtij udhëzimi.

5.2 Autoriteti përgjegjës mund të heqë emrin e një personi nga regjistri i përmendur në shkronjën “a”, të pikës 5.1, të kësaj pike, kur personi paraqet mangësitë:

a) për pjesëmarrje në kursin e trajnimit;

b) në plotësimin e kënaqshëm të një kursi të trajnimit periodik;

c) në drejtim të kryerjes në një mënyrë jo korrekte të inspektimeve të mjeteve.

KREU III

Procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR të mjetit

6. Certifikata e miratimit ADR të mjetit

6.1. Kjo pikë zbatohet te një mjet, i cili përdoret për qëllime të transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, ku rregullat e këtij udhëzimi dhe/ose pjesa 9 e ADR, zbatohen.

6.2. Pronari i mjetit të plotë ose të plotësuar aplikon për certifikatën e miratimit ADR të mjetit te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Aplikimi së bashku me dokumentet që përcaktohen në këtë udhëzim dërgohen me postë. Aplikimi nuk pranohet nëse kërkohen më pak se 10 ditë pune para datës për inspektimin e kërkuar.

6.3. Aplikimi për mjetet e përdorur në transportin e mallrave të rrezikshme konsiderohet i pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbi-



meve të Transportit Rrugor, pasi pronari i mjetit ka plotësuar formularin e aplikimit sipas modelit, i cili është paraqitur në aneksin 1, të shtojcës I, ka paguar detyrimet financiare, dhe ka shoqëruar me kopjet e dokumenteve të nevojshme të specifikuara në pikën 7, të këtij udhëzimi.

6.4. Certifikata/dëshmia origjinale sipas shkronjës “b”, të pikës 7.1, të këtij udhëzimi që mjetit është i pastër, dorëzohet ditën e caktuar për inspektimet e mjetit ADR.

6.5. Zyra përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor shqyrton dokumentacion sipas pikës 7.1 dhe cakton ditën për inspektimin teknik ADR vetëm nëse dokumentacioni është i rregullt. Ky dokumentacion së bashku me ose “Certifikatën e miratimit ADR për disa mjete që transportojnë mallra të rrezikshme” ose “Certifikatën e miratimit ADR (vetëm për transportin e brendshëm) për disa mjete që transportojnë mallra të rrezikshme”, të parapërgatitur (të printuar në modelin e para-numërtuar) për firmë dërgohet në qendrën e inspektimit ADR të mjetit, të zgjedhur nga klienti, për të inspektuar mjetin me qëllim përputhjen e tij me pjesën 9 të ADR përkundrejt klasave të mallrave të rrezikshme, të cilat janë përcaktuar në kërkesë.

6.6 Kur zyra përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor konstaton se aplikimi së bashku me dokumentet nuk janë të sakta, ajo kthen të gjithë dokumentacionin, brenda 10 ditëve, te aplikuesi duke e shoqëruar me të gjithë vërejtjet që duhet të plotësoj aplikuesi.

7. Dokumentet për inspektimin

7.1. Dokumentet e aplikimit për certifikatën e miratimit ADR janë si vijon:

a) modeli i aplikimit për certifikatën e miratimit ADR, sipas aneksit 1, të shtojcës I, plotësohet nga pronari ose këshilltari i sigurisë së mallrave të rrezikshme ose pronari të mjetit. Aplikimet bëhen për secilin mjet më vete (d.m.th. për mjetin motorik, rimorkion, gjysmë-rimorkion) për të cilin kërkohet një certifikatë miratimit ADR;

b) certifikata/dëshmia e pronarit ose operatorit ose të autorizuarit të personit fizik ose juridik, sipas modelit i cili jepet në aneksin 2, të shtojcës I, që mjeti është i sigurt për inspektim;

c) certifikata e kontrollit teknik vjetor të mjetit

sipas udhëzimit nr. 2, datë 11.03.2010 e lëshuar jo më shumë se 40 ditë para ditës së caktuar për inspektim;

ç) dokumentet e cisternës, për mjetet-cisternë sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “g”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, sipas modelit 013, të paraqitur në aneksin 9, të shtojcës I:

i. certifikata e inspektimit fillestar të cisternës për rastin kur cisterna nuk i është nënshtruar inspektimit periodik, ose

ii. certifikata e inspektimit periodik të fundit kur është në fuqi, ose

iii. certifikata e inspektimit jashtë radhe, nëse është bërë pas inspektimit periodik paraardhës ose pas inspektimit fillestar nëse nuk i është nënshtruar inspektimit fillestar.

d) certifikata e miratimit ADR:

i. të vitit paraardhës, për mjetin e përdorur, ose

ii. nga prodhuesi, kur mjeti është i ri (i regjistruar për herë të parë), ose

iii. deklaratën e kombinuar të konformitetit nga prodhuesi që i bashkëlidhet formularit të aplikimit sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7.2 Kushti sipas shkronjës “c”, të nënpikës 7.1 nuk do të zbatohet kur periudha ndërmjet datës së regjistrimit të parë të mjetit dhe datës së caktuar për inspektim është më e vogël se një vit.

7.3 Dokumentet e shkronjës “c”, “ç” dhe “d”, të nënpikës 7.1 duhet të jenë kopje e dokumenteve origjinale. Dokumentet origjinale paraqiten ditën e caktuar për inspektim.

7.4 Trupa e inspektimit inspekton lejen e drejtimit të drejtuesit të mjetit ose në rrethana të jashtëzakonshme, forma të tjera të specifikuara ose foto identifikimi, të tilla si pasaportat dhe regjistron detaje e personave që prezantojnë mjetin për inspektim.

8. Inspektimi i mjetit

8.1 Inspektori teknik i autorizuar në trupën e inspektimit ADR të mjetit, duhet kryej kontrollat:

a) nëse mjeti është i regjistruar në zyrën e tatimeve ku operatori është i vendosur;

b) për numrin e identifikimit që paraqitet në Certifikatën e Miratimit të pranuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, që korrespondon me numrin e identifikimit të mjetit të paraqitur për inspektim;

c) për/kërkoj certifikatën origjinale të cister-



nës dhe e ballafaqon atë me kopjen nga DPSHTRR;

ç) për/kërkoj deklaratat origjinale dhe i ballafaqon ato me kopjet e dërguara nga DPSHTRR;

d) për/kërkoj certifikatën e kontrollit teknik origjinale e cila duhet të jetë brenda 40 ditëve kalendarike;

8.2 Nëse gjatë këtij kontrolli konstatohen mospërputhje, procedurat për inspektimet ADR të mjetit nuk vazhdojnë.

8.3 Riinspektimi teknik ADR kryhet vetëm për ato pjesë ose nyje e detaje, për shkak të të cilëve certifikata e miratimit ADR të mjetit është refuzuar.

8.4 Inspektimi i mjetit të përmendur sipas kësaj pike kryhet vetëm nga inspektorë teknik, të cilët ndodhen në regjistrin e personelit të trajnuar të përmendur në pikën 5, të këtij udhëzimi.

8.5 Inspektimi dhe riinspektimi teknik i mjetit ADR sipas kësaj pike nuk kryhet, nëse pronari i mjetit/drejtuesi i mjetit nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e kontrollit së bashku me mjetin dhe me dokumentet origjinale sipas pikës 7 të këtij udhëzimi.

9. Procedurat e inspektimeve të mjetit dhe lëshimi i certifikatës së miratimit ADR

9.1 Procedurat e inspektimeve ADR të mjetit janë si vijon:

a) inspektimi i mjetit ADR kryhet në hapësira të miratuara për inspektim, me qëllim shmangien e aksidenteve ose incidenteve në njerëz, kafshë ose mjedis;

b) sigurohuni që në afërsi të vendit ku mjeti është duke u inspektuar nuk kryhen punime të natyrës me çlirim energjie, si saldime, mprehje instrumentesh, punime metalpresëse apo me gurë smeril, etj.;

c) inspektoni pjesët e poshtme, si shasia dhe pjesët e lëvizshme janë të pastra. Nëse nuk janë të tilla, inspektimi nuk vazhdon;

ç) sigurohuni që numri serial i cisternës përputhet me numrin serial të certifikatës së cisternës.

d) zgjidhni modelin korrekt të raportit të inspektimit të drejtuesit teknik të autorizuar, sipas anekseve 11 dhe 12, të shtojcës I. Kjo përcaktohet nga spontimi (çekimi) i seksionit (rubrikës) 7 sipas pikës 6.5, të certifikatës së miratimit ADR;

dh) plotësoni raportin e inspektimit sipas modelit të anekseve 11 dhe 12, të shtojcës I, dhe e arkivoni për ruajtje për 10 vjet nga data e inspektimit teknik.

9.2 Nëse mjeti kalon testimin e tij dhe dokumentet e mjetit sipas pikës 8, rezultojnë të rregullt, drejtuesi teknik i qendrës së inspektimit, nënshkruan certifikatën e miratimit ADR dhe e lëshon atë si vijon:

a) kopjen me ngjyrë të bardhë ia lëshon pronarit të mjetit/drejtuesit të mjetit;

b) kopjen me ngjyrë të verdhë e mban për vete së bashku me raportin sipas modelit të anekseve 12 dhe 13, të shtojcës I; dhe

c) kopjen e tretë, me ngjyrë të gjelbër, e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

9.3 Në rastin kur mjeti nuk kalon testin, drejtuesi teknik i qendrës së inspektimit, shkruan mbi Certifikatën e Miratimit njoftimin: “REFUZOHET”, sipas modelit të aneksit 7, të shtojcës I, dhe e lëshon atë si vijon:

a) kopjen e bardhë ia dorëzon drejtuesit të mjetit;

b) kopjen e verdhë e mban për vete duke e arkivuar atë për 3 vjet;

c) kopjen e gjelbër ia dërgon DPSHTRR-së.

9.4 Modeli i certifikatës së miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar është në përputhje me nënseksionin 9.1.3.5 të marrëveshjes ADR dhe i paraqitur në aneksin 5, të shtojcës I.

9.5 Certifikata e miratimit ADR ka përmasat 210 mm X 297 mm (formati A4). Ajo përdoret në të dy anët, para dhe mbrapa. Ngjyra e certifikatës është e bardhë. Certifikata ka një shirit diagonale ngjyrë rozë në të dy faqet e saj (në faqen e parme dhe të pasme).

9.6 Certifikata e miratimit ADR për mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar të disa mallrave të rrezikshme hartohet në gjuhën shqipe, ndërsa titulli i certifikatës dhe shënimet, sipas seksionit (pozicionit) nr. 11, do të hartohen, gjithashtu, edhe në anglisht.

9.7. Në dallim nga certifikata e miratimit ADR për transportin ndërkombëtar, për mjetet në transportin brenda vendit të mallrave të rrezikshme përdoret i njëjti format dhe me të njëjtën përmbajtje, por me emërtimin “CERTIFIKATË E MIRATIMIT PËR MJETET (VETËM PËR BRENDË VENDIT)



QË TRANSPORTOJNË DISA MALLRA TË RREZIKSHME”, aneksi 6, i shtojcës I.

9.8. Certifikata e miratimit ADR për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme është e vlefshme edhe për transportin e mallrave të rrezikshme brenda vendit.

9.9. Certifikata e miratimit ADR për mjetin – cisternë të mbeturinave të operuara në vakum do të vendoset shënimi si vijon: “mjet-cisternë që operon në vakum”.

10. Afatet kohore në kryerjen e një inspektimi

10.1 Data e fundit për kryerjen e një inspektimi teknik të mjetit ose riinspektim ADR të tij është 60 ditë nga data e pranimit të dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

10.2 Nëse inspektimi i mjetit ADR nuk kryhet brenda datës së përmendur në pikën 10.1, të kësaj pike, të gjithë dokumentet duhet të kthehen te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Asnjë lloj inspektim teknik ADR nuk kryhet nëse dokumentacioni ka kaluar kufirin kohor prej 60 ditësh.

11. Refuzimi për inspektimet ADR të mjetit

11.1 Një drejtues teknik refuzon pranimin për inspektimin e mjetit për arsye të:

a) nivelit të lartë të ndotjes ose kushtit të rrezikshëm të ndonjë prej pjesëve ose ndonjë prej pajisjeve të mjetit që e bëjnë të vështirë inspektimin;

b) ngarkesës së plotë ose të pjesshme me mallra të rrezikshme mbi mjet, e cila është në kundërshtim me shënimet në aneksin 2, të shtojcës I;

c) ndodhjes së mallrave të rrezikshme të ndryshme nga ato të deklaruara në aneksin 2 të shtojcës I, për kryerjen e kontrollit ADR;

ç) kur inspektimi do të paraqiste rrezikshmëri, ose

d) mosshoqërimit të mjetit me një drejtues mjeti i cili nuk është i pajisur me dëshminë përkatëse për llojin e mallit/substancës të rrezikshëm që mbart mjeti.

12. Rastet kur nuk kryhet inspektimi i mjetit

12.1. Një inspektim i mjetit të plotë ose të plotësuar për përfundimin e certifikatës së miratimit ADR nuk kryhet:

a) në lidhje me datën më të fundit sipas pikës 10.1, të këtij udhëzimi;

b) për arsye të mosplotësisë së kërkesave të pikave 6, 7 dhe 8, të këtij udhëzimi, ose

c) për arsye të refuzimit për pranimin e mjetit sipas pikës 11, të këtij udhëzimi.

13. Vlefshmëria e certifikatës së miratimit ADR

13.1 Një certifikatë e miratimit ADR të një mjeti të plotë ose të plotësuar, e lëshuar sipas nënpikës 9.2, të pikës 9, të këtij udhëzimi pas përfundimit të një inspektimi, është e vlefshme:

a) subjekt tek shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj pike, për periudhën një vjeçare nga data e lëshimit;

b) subjekt te shkronja “c”, afati pasues i miratimit lidhet me datën e fundit të shfuqizimit, të shënuar, nëse inspektimi teknik kryhet brenda 30 ditëve para ose pas kësaj date, ose

c) në rastin e cisternave, subjekt te inspektimi periodik i detyrueshëm, nuk nënkupton se provat e hermeticitetit, provat e presionit hidraulik ose inspektimet e brendshme e të jashtme të cisternave do të kryhen në intervale më të shkurtra se ato të parashikuara në kapitujt 6.8 dhe 6.9 të ADR.

14. Zëvendësimi i certifikatës së miratimit ADR të mjetit

14.1. Kur certifikata e miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar ka humbur, është shkatërruar ose është prishur pjesërisht, drejtuesi teknik lëshon një certifikatë zëvendësuese, e cila përmban dukshëm shënimin “ZËVENDËSUESE”.

14.2. Kur një certifikatë e miratimit ADR të mjetit të plotë ose të plotësuar e lëshuar është bërë e palexueshme, ose ngjyra e certifikatës ka ndryshuar nga ndonjë veprim ose pakujdesi nga zotëruesi i certifikatës, drejtuesi teknik lëshon një certifikatë zëvendësuese, e cila përmban dukshëm shënimin “ZËVENDËSUESE”.

14.3. Afati i përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës zëvendësuese të miratimit ADR të mjetit është i njëjtë me afatin e certifikatës së miratimit ADR, të cilën ka zëvendësuar.

15. Transferimi i certifikatës së miratimit ADR të një mjeti

15.1 Certifikata ADR e mjetit është e pa transferueshme.

15.2 Si përjashtim nga pika 15.1 e këtij neni, transferimi i certifikatës së miratimit ADR të mjetit, që transporton mallra të rrezikshme,



lejohej të transferohet te një palë tjetër, e cila e ka blerë atë, sipas kushteve të mëposhtme:

a) të paraqesë një aplikim për transferimin certifikatës së miratimit ADR të mjetit;

b) të bashkëlidhë një kopje të lejes së qarkullimit (që tregon të dhënat e pronarit të ri dhe detajet e mjetit);

c) të bashkëlidhë certifikatën ekzistuese të miratimit ADR të mjetit (e përfutur nga pronari i vjetër i mjetit).

15.3 Transferimi kryhet brenda 21 ditëve duke filluar nga dita e shitjes së mjetit te pronari i ri.

15.4 Aplikimi për transferimin do të pranohet vetëm në rast se certifikata ekzistuese e miratimit ADR të mjetit ka më shumë se 60 ditë para afatit të zhvlerësimit. Në rast të kundërt, aplikimi i kryer nga pronari i ri do të kryhet në të njëjtën mënyrë si në një aplikim të zakonshëm.

16. Regjistrimi i veprimtarisë

16.1 Trupa e inspektimit ADR të mjetit regjistron në një regjistër me shkrim dhe elektronik dhe dokumenton të gjithë veprimet që kryhen, për inspektimin e mjeteve të transportit të mallrave të rrezikshme, në përputhje me modelin e regjistrimit të paraqitur në aneksin 3, të shtojcës I.

16.2 Trupa e inspektimit ADR të mjetit ruan regjistrimet dhe dokumentacionin dhe furnizon herë pas here pas here, ose kur kërkohet, me informacion ministrinë dhe organet e tjera caktuara me ligj.

17. Numri i certifikatës së miratimit ADR të mjetit

17.1 Numri i certifikatës së miratimit ADR të mjetit, i cili tregohet në pozicionin 1 të modelit të certifikatës sipas nënseksionit 9.1.3.5 të ADR dhe anekseve 5 dhe 6, të shtojcës I, ndërtohet sipas modelit të paraqitur në aneksin 8, të shtojcës I.

17.2 Në përputhje me modelin e paraqitur në aneksin 8, të shtojcës I, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përcakton numrin e certifikatës së miratimit ADR në rubrikën 1, të certifikatës, sipas anekseve 5 dhe 6.

18. Anulimi i certifikatës së miratimit ADR të mjetit

18.1 Organet e kontrollit në rrugë, të përmendura në ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, mund të anulojnë një certifikatë të miratimit ADR të mjetit nëse kanë arsye të forta të besojnë, që certifikata e lëshuar është dhënë në

mënyrë jo të rregullt ose mënyrë të paligjshme. Në këtë rast, organet e kontrollit në rrugë vendosin shënimin “ANULUAR” duke e shoqëruar me emërtimin e organit të kontrollit, emrin e personit që e ka kontrolluar mjetin, firmën e personit dhe vulën e institucionit.

18.2. Kur organet e kontrollit në rrugë marrin vendimin për anulimin certifikatës së miratimit ADR sipas nënpikës 18.1, pronari i mjetit, të cilit i përket kjo certifikatë, ose mbajtësi i certifikatës, dorëzon brenda 7 ditëve certifikatën e miratimit ADR të mjetit te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila njofton menjëherë ministrinë, për numrin e serisë së certifikatës ADR së miratimit të mjetit dhe për arsyet e anulimit.

18.3 Kur organet e kontrollit në rrugë anulojnë një certifikatë mjeti të miratuar, menjëherë informojnë trupën e inspektimit që lëshoi certifikatën, ministrinë dhe DPSHTRR-në për numrin serial të certifikatës së mjetit të miratuar dhe arsyet e anulimit.

18.4 Nëse mjeti pëson dëmtime nga një aksident, organet e kontrollit, pas kryerjes së inspektimit, tërheqin certifikatën e miratimit ADR të mjetit që transporton mallra të rrezikshme dhe e dorëzojnë te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe njoftojnë menjëherë ministrinë.

19. Ndalimi kundër përdorimit të një mjeti, kur është duke transportuar mallra të rrezikshme, pa qenë i pajisur me certifikatën e miratimit ADR

19.1 Asnjë person nuk mund të përdorë një mjet, i cili është duke transportuar mallra të rrezikshme, te i cili dispozitat e ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, dispozitat e pjesës 9 të Marrëveshjes ADR, zbatohen për transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë, nëse ky mjet nuk ka një certifikatë të vlefshme të miratimit ADR në fuqi.

19.2 Certifikatat e miratimit ADR e lëshuar nga autoriteti kompetent i një prej Shteteve Anëtare, Palë Kontraktuese në ADR për mjetin e regjistruar në territorin e kësaj Pale Kontraktuese, do të pranohet nga organet mbikëqyrëse të përmendura në ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, për aq sa është brenda afatit të vlefshmërisë.

19.3 Një certifikatë miratimi ADR e lëshuar për çdo mjet në transportin ndërkombëtar është



e vlefshme edhe për transportin brenda vendit.

20. Kërkesat për shoqërimin me certifikatën e kontrollit teknik

20.1 Certifikata e miratimit ADR të mjetit nuk është e vlefshme për një mjet, i cili është duke transportuar mallra të rrezikshme, po të mos shoqërohet me certifikatën e kontrollit teknik në fuqi të mjetit, e lëshuar sipas udhëzimit nr. 2, datë 11.03.2010.

20.2 Pika 20.1 nuk zbatohet për sa i përket vlefshmërisë së certifikatës së miratimit ADR deri datën e vitit të parë të regjistrimit të parë të mjetit për të cilin certifikata e mjetit përmendet.

21. Detyrimet e trupës vëzhguese për funksionimin e trupës së inspektimit

21.1 Autoriteti përgjegjës cakton një trupë vëzhguese për vlerësimin e funksionimit të trupës së inspektimit ADR të mjetit për të përcaktuar nëse janë zbatuar rregullat sipas këtij udhëzimi.

21.2 Trupa vëzhguese ka të drejtë:

a) të vlerësojë nëse inspektimet dhe procedurat, që përfshijnë procedurat administrative, në lidhje me të gjithë funksionet e tyre sipas këtyre rregullave kryhen në mënyrën e përshtatshme dhe të duhur;

b) të vlerësojë nëse mjediset e qendrës së inspektimit ADR të mjetit e përdorur nga trupa inspektuese ose mjediset ose pajisjet e përdorura nga inspektorët teknikë, të autorizuar, janë të përshtatshme për kryerjen e funksioneve të tyre siç kërkohet për plotësimin e pjesës 9;

c) të inspektojë të gjithë regjistrimet ose dokumentacionin të cilin trupa inspektuese ose inspektori teknik, i autorizuar duhet ta mirëmbajë në përputhje me këtë udhëzim;

ç) të inspektojë të gjithë regjistrimet ose dokumentacionin e ruajtur nga trupa inspektuese ose inspektori teknik, i autorizuar në lidhje me funksionet e tyre sipas këtij udhëzimi;

d) të inspektojë një mjet tek i cili zbatohen këto rregulla;

dh) të rikthejë një certifikatë të miratimit ADR të mjetit në DPSHTRR sipas pikës 18; dhe

g) të dorëzojë një raport me shkrim te ministri për veprimtarinë e qendrës së inspektimit.

21.3 Para çdo kontrolli, trupa e inspektimit njoftohet 7 (shtatë) ditë para nga trupa vëzhguese për kontrollin e radhës që do të kryhet.

22. Mjetet ekzistuese (përjashtimet lidhur me transportin e brendshëm)

22.1. Pa cenuar sigurinë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme dhe në devijim nga pjesa 9 e ADR, mjetet e regjistruara para 1 prillit 2002 të pa përshtatura me sistemet antiblokazh dhe frenimin rezistent do të merren në përputhje me pikat 6-9 të kësaj rregulloreje për sa i përket kërkesave për sistemet anti-blokazh dhe frenimin rezistent në kapitullin 9.2.3.1 të ADR.

22.2. Mjetet-cisternë që plotësojnë kërkesat e ADR për mjetin bazë do të merren në përputhje me pjesën 9 të ADR, pavarësisht se cisternat dhe pajisjet e tyre nuk janë plotësisht në përputhje me kapitujt 6.7, 6.8, 6.9, 6.10 ose 6.12, sipas rastit, dhe të regjistruara para 1 korrikut 2003.

22.3 Inspektimi i cisternave kryhet nga trupat inspektuese në përputhje me seksionet 6.8.2 dhe 6.8.3 të ose standardin EN 12972-2007 “Cisternat për transportin e mallrave të rrezikshme-provat, inspektimi dhe markimi i cisternave metalike” dhe të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe veprimtaria e të cilave miratohet nga Ministri përgjegjës sipas nenit 19, të ligjit 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

23. Lëshimi i certifikatës së miratimit ADR për brenda vendit

Pavarësisht pikës 22, të këtij udhëzimi, inspektimi i një mjeti të përmendur në këtë udhëzim në përputhje me pjesën 9 të ADR, ku drejtuesi teknik është i kënaqur që mjeti përputhet me kërkesat e pjesës 9 të ADR, ky drejtues teknik lëshon Certifikatën e Miratimit ADR (vetën për transportin brenda vendit) për këtë mjet, sipas modelit në aneksin 6, të Shtojcës I dhe sipas procedurave të Kreut III.

KREU IV

Kushtet që duhet të plotësoj personi juridik për inspektimin ADR të mjetit

24. Përkufizime

Për qëllime të këtij kapitulli, “Kërkesat e përshkruara” nënkupton listën e artikujve që inspektohen dhe/ose testohen në përputhje me pjesën 9 të marrëveshjes ADR dhe/ose aneksit nr. 12.

25. Kushtet e licencimit qendrës së kontrollit teknik ADR



25.1 Trupa e inspektimit për përfitimin e licencës për kryerjen e inspektimit teknik të mjeteve ADR duhet të plotësojë kushtet apo dispozitat e këtij kreu. Licenca lëshohet nga Ministri me afat 5-vjeçar.

25.2 Pas 3 vjetësh, nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të gjithë trupat e inspektimit do të përfitojnë licencën vetëm nëse ato janë pajisur me një certifikatë në lidhje me ISO 9001 “Sistemet e Cilësisë për Trupat Inspektuese” nga një trup certifikimi akreditues për ISO 9001.

26. Pavarësia, paanësia, integriteti dhe konfidencialiteti

26.1. Trupa inspektuese do të jetë e pavarur për nivelin e kërkuar për sa i përket kushteve sipas të cilave kryhet inspektimi i mjetit.

26.2. Me qëllim garantimin që inspektimi i mjetit të kryhet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, trupa inspektuese (personi juridik që kryhen kontrollin) dhe stafi i saj:

a) nuk duhet të jetë nën ndikimin dhe, as nuk duhet të ketë lidhje direkt ose marrëdhënie me organizatat në fushën e mjetit, p.sh. prodhuesit apo projektuesit të mjeteve dhe kompanitë e transportit;

b) duhet të jenë të lirë nga çdo tregti e dorës së dytë, financiare dhe presion tjetër i cili mund të ndikojë në gjykimin e tyre dhe nuk përfshin ndonjë veprimtari tjetër që mund të rrezikojë besimin në ose konflikt me pavarësinë e tyre ose gjykimin dhe integritetin në lidhje me veprimtarinë e inspektimit të mjetit; në mënyrë të veçantë, nuk janë direkt të përfshirë në projekte, prodhimin, ose të ndonjë prej komponentëve, sistemeve ose pjesëve të tjera që lidhen drejtë për së drejti me mjetet rrugore.

26.3. Trupa inspektuese do të garantoj konfidencialitetin e të gjithë informacioneve personale të përfutur nga jashtë ose nga brenda gjatë veprimtarisë së inspektimit të mjetit.

26.4. Stafi i trupës inspektuese do të marrë përsipër në mënyrë kontraktuale për paanësinë/objektivitetin, integritetin/ndershmërinë dhe konfidencialitetin/ruajtjen e sekretit, dhe ndonjë shkelje e këtyre premtimeve mund të rezultojë me heqje nga puna.

27. Struktura organizative

27.1. Trupa inspektuese do të ketë një strukturë organizative që i jep mundësi asaj për mbajtjen e aftësive të saj të kryej inspektimet e

mjetit në mënyrë të përshtatshme dhe korrekte dhe me cilësinë e duhur.

27.2. Trupa inspektuese do të përbëhet nga administratori dhe/ose drejtuesi teknik dhe inspektorët teknikë, të autorizuar. Në rast mungese të drejtuesit teknik, ai duhet të zëvendësohet. Trupa inspektuese duhet të ketë emrin e personit që e zëvendëson.

27.3. Nëse një trupë inspektuese ka disa qendra inspektimi, ajo duhet të ketë në çdo qendër nga një asistent drejtues teknik.

27.4. Trupa inspektuese, e cila përbëhet prej jo më shumë se dy persona do të bëjë të mundur që i gjithë stafi, funksioni dhe detyrat e të cilit ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e inspektimeve të mjeteve duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe autoritetin e tyre në çështjet e cilësisë. Të gjithë funksionet do të jenë të përshkruara në mënyrë të qartë dhe të dokumentuara në përshkrimet e punës së caktuar, të cilët përfshijnë kërkesa minimale për edukimin, kualifikimet, trajnimin, njohuri teknike dhe eksperiencë.

27.5. Inspektorët teknik të autorizuar duhet të kenë kualifikim inxhinierik mbi mekanikën e mjeteve rrugore dhe teknologjinë e mjeteve ose në ndonjë fushë të ngjashme dhe të paktën një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet. Drejtuesi teknik, përveç kualifikimit dhe eksperiencës së përmendur në këtë paragraf, duhet të jetë i pajisur edhe me certifikatë për inspektimin e mjeteve ADR.

27.6. Trupa mund të ketë në përbërje të saj teknikë të mesëm, të cilët lejohen të merren me përpunimin e dokumentacionit. Teknikët e mesëm duhet të kenë të paktën një arsim të mesëm mbi mekanikën e mjeteve rrugore dhe teknologjinë e mjeteve për të pasur mundësi që të gjykojnë profesionalisht mbi konformitetin e mjetit për kërkesat e përshkruara.

27.7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor harton një program trajnimi dhe duhet të sigurojë që drejtuesi teknik dhe inspektorët teknikë, të autorizuar, funksionet dhe puna e të cilëve ndikojnë në cilësinë e inspektimeve të mjetit të marrin pjesë rregullisht në kurset e trajnimit.

27.8. I gjithë stafi duhet të trajnohet për të operuar në mënyrë korrekte lidhur me cilësinë e inspektimeve dhe procedurat e tij dhe doku-



mentet. Kursi i trajnimit ose edukimit për të gjithë stafin e trupës do të zgjasë të paktën 40 orë në 2 vjet (5 ditë pune).

Trajnimi kryhet në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimeve të Transportit Rrugor nga persona të kualifikuar, të cilët janë të trajnuar dhe certifikuar për këtë qëllim ose janë të specializuar në fushën e legjislacionit për transportin e mallrave të rrezikshme për një periudhë më të gjatë se 5 vjet.

27.9. Kurset e trajnimit dhe edukimit marrin parasysh kualifikimet e eksperiencën e stafit të përfshirë dhe nevojat e trajnimit individual të kërkuara për ekzekutim të kënaqshëm, në mënyrë të veçantë për rekrutët e rinj ose stafit të transferuar në një detyrë të re.

27.10. Kurset e edukimit do të përfshijnë trajnimin specifik të nevojshëm për kryerjen e inspektimeve të mjeteve dhe do të fokusohet në zhvillimet e reja të teknikës dhe ndryshimet e fundit dhe mendimet e kërkesave të përshkruara, me qëllim mbajtjen e stafit, në mënyrë të veçantë të drejtuesve dhe inspektorët teknikët, të autorizuar, të përditësuar.

27.11. Trupa inspektuese mban të përditësuar regjistrimet rreth kualifikimeve, trajnimit dhe eksperiencës të çdo anëtarit të stafit, e cila mund të përdoret për të identifikuar të gjithë boshllëqet në trajnim.

27.12. Stafi i çdo trupe të inspektimit është i veshur me uniformën përkatëse ku mbi të lejohet të vendoset emri i personit juridik. Uniforma të jetë praktike dhe të mos sjellë pengesa në veprimet e punonjësve gjatë punës.

27.13. Trajnimi ose edukimi dhe rifreskimit përmbajnë temat teorike dhe praktike:

a) Trajnimi ADR, i cili përfshin modulet e mëposhtme, për:

i. njohuritë e përgjithshme mbi mallrat e rrezikshme;

ii. njohuritë e përgjithshme mbi mjetet që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme;

iii. njohuritë e përgjithshme për personat e përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme;

iv. njohuritë e përgjithshme për cisternat që mbartin mallra të rrezikshme;

v. bazën ligjore për kryerjen e testit të mjeteve që mbartin mallra të rrezikshme;

vi. rregullat e testit dhe mënyra e ekzekutimit të tij;

vii. dokumentimin e testit duke përfshirë edhe raportin e inspektimit;

viii. sigurinë gjatë zhvillimit të testit;

ix. praktikën më të mirë të trupës së inspektimit, specifik për ADR dhe kërkesat minimale;

b) Rifreskimin, i cili zhvillohet çdo 2 vjet me modulet e mëposhtme:

i. trajnimi për rifreskim ose ndryshimet në legjislacion, mbi:

- njohuritë për mjetet që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe ndryshime nëse ka;

- njohuritë e përgjithshme për personat e përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme;

- njohuritë e përgjithshme për cisternat që mbartin mallra të rrezikshme;

- bazën ligjore për kryerjen e testit të mjeteve që mbartin mallra të rrezikshme;

ii. ndryshimet e testit nëse ka;

iii. zonat delikate në kryerjen e testit;

iv. dokumentimin e testit duke përfshirë edhe raportin e inspektimit;

v. rifreskimi i përgjithshëm për sa i përket:

- kujdesit për klientin;

- konflikteve të interesit;

- rezultateve të procesit të inspektimit së qendrës së inspektimit; dhe

- praktika e mirë e qendrës së inspektimit.

27.14. Pas trajnimit ose edukimit dhe rifreskimit kryhet një testim, duke kombinuar teorinë dhe praktikën. Pas kalimit të testit, inspektorët e autorizuar pajisjen me certifikatë me afat pesë vjet.

28. Lehtësira për inspektimin mjetit dhe pajisjet

28.1. Trupa e inspektimit siguron lehtësira të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe pajisje për kryerjen e inspektimeve të mjetit në konformitet me kërkesat e përshkruara që janë në dispozicion.

28.2 Trupa e inspektimit të mjetit disponon hapësira të mjaftueshme për parkimin e mjeteve që presin për t'u inspektuar.

28.3. Ndërtesat e përdorura si qendra të inspektimit të mjetit duhet:

a) të kenë dyer të ndryshme, për hyrje dhe për dalje;

b) të kenë dhoma dhe hapësira të mjaftueshme për specialistët/teknikët për kryerjen e inspektimeve të mjetit në mënyrë të përshtat-



shme dhe korrekte dhe në kushte të sigurtë e të parrezikshme;

c) të jetë e pajisur me sistem ngrohje dhe ventilimi;

ç) të ketë parking të jashtëm të mjaftueshëm e të përshtatshëm për të paktën 5 mjete që presin për inspektim;

d) të ketë lehtësira sanitare të përshtatshme, veç për stafin dhe veç për vizitorët;

dh) të ketë një sipërfaqe të lirë në hapësirë jo më të vogël se 1.000 m²;

e) të jetë i pajisur me sistem/sisteme për mbrojtjen nga zjarri (leje nga MNZ);

ë) të ketë një gropë me shkallë me gjatësi jo më të vogël se 14 m gjatësi dhe të paktën 0.9 gjerësi.

28.4. Në mënyrë të veçantë, trupa e inspektimit teknik ka të vlefshme për përdorim pajisje, ndriçim artificial në gropë, manometër për matjen e presionit të ajrit, mjedise dhe personel të aftë për inspektimin e pjesëve e mjeteve ADR.

28.5. Trupa e inspektimit teknik mund të kenë në disponueshme dhe/ose përdorin pajisje shtesë për qëllime specifike.

29. Vlerësimi i standardeve

29.1. Ministri ngre një trupë certifikuese për vlerësimin e një trupe të inspektimit ADR. Asnjë prej anëtarëve të trupës certifikuese sipas pikës 29.2, të kësaj pike, nuk duhet të jetë punonjës apo drejtues apo i lidhur me çfarëdo detyre me një trupë të inspektimit ADR ose me ndonjë organ nga e cila varet apo ka në varësi kjo trupë inspektimit ADR.

29.2. Trupa certifikuese përbëhet prej tre personave, specialistë të fushës përkatëse, e cila përbëhet kryetari dhe dy anëtarë. Vlerësimi i çdo trupe të inspektimit ADR do të kryhet në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi

29.3. Pas vlerësimit të trupës së inspektimit ADR, trupa certifikuese plotëson një raport të hollësishëm mbi plotësimin e kushteve nga personi juridik, i cili firmoset nga e gjithë trupa certifikuese dhe nga i interesuari për përfitimin e licencës të qendrës së inspektimit ADR.

29.4. Nëse trupa e inspektimit ADR plotëson kushtet e vendosura në këtë udhëzim, trupa certifikuese i propozon ministrit lëshimin e licencën.

29.5 Trupa certifikuese sipas pikës 29.1 mund

të kontrollojë në çdo moment trupën e inspektimit edhe nëse kjo e fundit është vlerësuar ose është penalizuar më parë nga trupa vëzhguese e DPSHTRR.

30. Shpërndarja dhe përcaktimi i qendrave të inspektimit

30.1. Inspektimi i mjeteve ADR do të shtrihet në të gjithë territorin e vendit.

30.2. Çdo trupë inspektimi të mjeteve ADR është e detyruar të pasqyrojë në faqen e saj të internetit adresën e vendndodhjes, numrat e telefonit, faksit, adresën e informacionit elektronik dhe çdo të dhënë tjetër që sjell lehtësimin e veprimeve të klientëve.

KREU V

Kërkesat në lidhje me konstruksionin e mjeteve

31. Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme për periudhën nga 30 qershorit 1993 deri më 1 janar 1997

31.1. Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme me kod EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT, të prodhuara ndërmjet 30 qershorit 1993 dhe 1 janarit 1997 në Shtetet Anëtare të BE në përputhje me kërkesat kombëtare në fuqi deri më 31 Dhjetor 1996 të këtyre shteteve, por që nuk përputhen me kërkesat e ADR, lejohen të përdoren në transportin e mallrave të rrezikshme brenda vendit, me kusht që këto mjete të plotësojnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Në këtë rast, kujdes i veçantë duhet të tregohet në plotësimin e aplikimit sipas aneksit 1, të shtojcës I dhe lëshimit të certifikatës së miratimit ADR për herë të parë sipas aneksit 6, të shtojcës I.

31.2. Gjatë inspektimit të mjeteve, subjekt të nënpika 31.1, kryhet verifikimi nëse mjetet motorike dhe rimorkiot e gjysmë – rimorkiot janë në përputhje me kërkesat për pajisjet e frenimit sipas nënseksionit 9.2.3.1.

31.3. Nëse verifikimi i kryer sipas nënpikës 31.2 nuk është pasqyruar në dokumentet shoqëruese të mjetit, prodhuesi i mjetit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, lëshon një deklaratë të konformitetit në përputhje me paragrafin e fundit të nënseksionit 9.1.2.1 të ADR: “Kur mjeteve iu kërkohej të përshtaten me sistemin e rezistencës në frenim (zgjatje e frenimit), prodhuesi i mjetit ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij lëshojnë një deklaratë të konformitetit me përshkrimet përkatëse të



aneksit 5, të rregullores nr. 13/ECE. Kjo deklaratë paraqitet në inspektimin e parë teknik”.

31.4. Për periudhën ndërmjet 30 qershorit 1993 dhe 1 janarit 1997, mjetet e mëposhtme janë të përshtatur me pajisjet e frenimit:

a) Sistemi i frenimit antibllokazh:

- është i aplikueshëm te mjetet e regjistruar për herë të parë pas 30 qershorit 1993 për sa i përket mjeteve motorike (tërheqës dhe kamionë) me masë maksimale që i kalon 16 tonë dhe mjetet me motor të autorizuar për tërheqjen e rimorkiove (d.m.th. rimorkio të plotë, gjysmërimorkio ose rimorkio me aks qendror) me një masë maksimale që i kalon 10 tonë. Gjithashtu është i aplikueshëm për mjetet motorike për tërheqjen e rimorkiove me një masë maksimale që i kalon 10 tonë, të regjistruar për herë të parë pas 30 qershorit 1995. Te këto mjete duhet të lëshohet certifikata e miratimit për herë të parë në përputhje me pikën 9.1.2 të ADR pas 30 qershorit 2001 pavarësisht datës në të cilën janë regjistruar për herë të parë. Mjetet motorike duhet të pajisen me kategorinë 1 të sistemit të frenimit antibllokazh.

- është i aplikueshëm te rimorkiot (d.m.th. rimorkio e plotë, gjysmë-rimorkio ose rimorkio me aks-qendror) me një masë (peshë) maksimale që i kalon 10 tonë. Rimorkiot duhet të pajisen me kategorinë A të sistemit antibllokazh.

b) Sistemi i rezistencës në frenim:

është i aplikueshëm te mjetet me motor me një masë maksimale që i kalon 16 tonë ose të autorizuar për tërheqjen e një rimorkio me një masë maksimale që i kalon 10 tonë. Sistemi i rezistencës në frenim duhet të jetë tipi IIA.

32. Mjetet për transportin e mallrave të rrezikshme pas 1 janarit 1997

32.1 Mjetet EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT duhet të përputhen me kërkesat e pjesës 9, të ADR.

32.2. Çdo mjet i plotë ose i plotësuar është subjekt i inspektimit të parë nga trupa e inspektimit e licencuar, për verifikimin e konformitetit me kërkesat teknike përkatëse të kapitujve 9.2 — 9.8 të ADR dhe tabelave “H”, “I” dhe “J”, të Aneksëve 12 dhe 13, të shtojcës I.

32.3. Trupa e inspektimit mund të heqë dorë nga inspektimi i parë për tipin e miratuar për një tërheqës për një gjysmërimorkio në përputhje me pikën 9.1.2.2 të ADR për të cilën prodhuesi ose

përfaqësuesi i akredituar nga prodhuesi kanë lëshuar një deklaratë (certifikatë) të konformitetit sipas kërkesave të kapitullit 9.2 të ADR dhe të anekseve 2 dhe 12, të shtojcës I.

32.4. Konformiteti i mjetit certifikohet përmes lëshimit të certifikatës së miratimit ADR në përputhje me pikën 9.1.3 të ADR.

32.5. Kur një mjet i kërkohet të pajiset me sistemin e rezistencës në frenim, prodhuesi i mjetit ose përfaqësuesi i tij i akredituar duhet të lëshoj një deklaratë të konformitetit me përshkrimet e aneksit 5, të rregullores nr. 13 të ECE. Kjo deklaratë paraqitet në inspektimin e parë.

32.6. Në inspektimin për miratimin ADR, vetëm pjesët e tipit të miratuar të mjetit jo të plotë, të cilat janë shtuar ose modifikuar në procesin e plotësimit, duhet të inspektohen për përputhjen me kërkesat e aplikueshme të kapitullit 9.2 të ADR.

32.7. Për periudhën pas 1 janarit 1997 mjetet e mëposhtme janë të përshtatur me pajisjet e frenimit:

a) Sistemi i frenimit antibllokazh:

- është i aplikueshëm te mjetet (tërheqës dhe kamionë) me masë maksimale që i kalon 16 tonë dhe mjetet me motor të autorizuar për tërheqjen e rimorkiove (d.m.th. rimorkio të plotë, gjysmërimorkio ose rimorkio me aks qendror) me një masë maksimale që i kalon 10 tonë. Mjetet motorike duhet të pajisen me kategorinë 1 të sistemit të frenimit antibllokazh.

- është i aplikueshëm te rimorkiot (d.m.th. rimorkio të plotë, gjysmë-rimorkio ose rimorkio me aks qendror) me një masë (peshë) maksimale që i kalon 10 tonë. Rimorkiot duhet të pajisen me kategorinë A të sistemit antibllokazh.

b) Sistemi i rezistencës në frenim:

- është i aplikueshëm te mjetet me motor me një masë maksimale që i kalon 16 tonë ose të autorizuar për tërheqjen e një trileri me një masë maksimale që i kalon 10 tonë. Sistemi i rezistencës në frenim duhet të jetë tipi IIA.

33. Mjetet e tipit EX/II dhe EX/III për transportin e lëndëve plasëse (LP)

33.1. Mjetet motorike ose rimorkiot e përdorur për herë të parë më ose pas datës 1 janar 1997 që janë përdorur për mbartjen ose tërheqjen e një rimorkio që përmban eksplozivë në udhëtimet brenda vendit.



33.2. Mjetet motorike ose rimorkiot, e përdorur për transportin ose tërhequr një rimorkio që përmban eksplozivë në udhëtimet ndërkombëtar janë mjetet EX/II dhe EX/III si vijon:

a) mjetet EX/II dhe EX/III shërbejnë për transportin e lëndëve plasëse (LP), substancat dhe artikujt e klasës 1. Këto mjete duhet të përmbushin kërkesat për konstruksionin e mjeteve sipas kapitullit 9.2 të ADR dhe tabelës “H”, të aneksit 12, të shtojcës I.

b) kërkesat shtesë në lidhje me konstruksionin, kushtet e pajisjet e mjeteve EX/II dhe EX/III të plotë ose të plotësuar të destinuar për transportin e substancave dhe artikujve eksplozivë (klasa 1) të ADR në paketa jepen në kapitullin 9.3 të ADR dhe sipas tabelës “I”, të aneksit 12, të shtojcës I.

34. Mjetet e tipit FL, OX dhe AT (mjetet cisternë)

34.1. Mjetet-cisternë me kod FL, OX dhe AT shërbejnë për transportin e substancave dhe artikujve të cilët janë në gjendje të gaztë, të lëngët ose substancave në gjendje pudre ose të granular.

34.2. Menjëherë pasi cisterna e çmontueshme është vendosur në mjet, e tërë njësia do të plotësojë kushtet e parashikuara për mjetet-cisternë.

34.3. Cisternat duhet të përmbushin kërkesat sipas kapitujve 6.2 deri në 6.8 të ADR. Inspektimi periodik, i ndërmjetëm, jashtë radhe dhe provat në hermeticitet i cisternave kryhen nga organet e miratuara nga ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë. Pas kontrollit, trupat inspektuese të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të miratuara nga ministri përgjegjës lëshojnë formularin mod.013, sipas aneksit nr.9, të shtojcës I.

34.4. Mjetet me kod FL, OX dhe AT duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me konstruksionin e mjeteve sipas kapitullit 9.2 të ADR, tabelës “H” të aneksit 11, të shtojcës I, si dhe kërkesat shtesë sipas kapitullit 9.7 të ADR dhe tabelës “J” të aneksit 11, të shtojcës I.

35. Mjetet e tjera

35.1. Certifikata e miratimit ADR nuk kërkohet për mjetet e ndryshëm nga mjetet EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT, kur transporti i mallrave të rrezikshme, lejohet nga ADR, të

kryhet me këto mjete, përveç certifikatës së kontrollit teknik e kërkuar për rregullat e përgjithshme të sigurisë sipas udhëzimit nr. 2, datë 11.3.2010.

35.2. Për mjetet e ndryshëm nga mjetet me kod EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT:

a) kërkesat e nënseksionit 9.2.3.1.1 të ADR (Pajisja e frenimit në përputhje me ECE rregulloren nr. 13 ose direktivën 71/320/EC) janë të aplikueshme te të gjithë mjetet e regjistruara për herë të parë pas 30 qershorit 1997;

b) kërkesat e nënseksionit 9.2.5 të ADR (pajisja e kufizimit të shpejtësisë në përputhje me ECE Rregulloren 89 ose direktivën 92/24/EEC) janë të aplikueshme te të gjithë mjetet motorike me një masë maksimale që e kalon 12 tonë të regjistruar për herë të parë pas 31 dhjetorit 1987 dhe të gjitha mjetet motorike me një masë maksimale që i kalon 3.5 tonë, por jo më shumë se 12 tonë të regjistruar për herë të parë pas 31 dhjetorit 2007.

36. Ruajtja e dokumenteve

36.1. Si rezultat i veprimtarisë së organeve të përmendura në këtë udhëzim, organet që gjenerojnë dokumente janë ato të përmendura në anekset 5 dhe 6, të shtojcës I.

36.2. Dokumentet e përmendura në këtë udhëzim, duke përfshirë edhe veprimet negative, duhet të mirëmbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (PSHTRR) dhe trupa e inspektimit teknik për një periudhë prej 10 vjetësh ose deri në datën e shfuqizimit të dokumentit kur ai shfuqizohet në një periudhë prej më shumë se 10 vjet.

37. Publikimi

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës publikon në faqen e *website* të saj të dhënat për të gjithë trupat inspektimit të mjeteve ADR.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor publikon në faqen e saj të internetit këtë udhëzim anekset A dhe B, të ADR në fuqi.

38. Aktet në fuqi

Certifikatat e miratimit ADR për mjetet, të lëshuara nga DPSHTRR para ditës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi janë të vlefshme deri më datën e paraqitur në të.

39. Vazhdimësia e ruajtjes së dokumentacionit



Në rast se një trupë inspektimi mbyll veprimtarinë e saj, ajo transferon dokumentacionin teknik në zotërim të saj në trupën e inspektimit që cakton Ministri.

40. Penalitet

Mosplotësimi i dispozitave të këtij udhëzimi, lidhur me procedurat e inspektimit të mjeteve ADR dhe plotësimin e kushteve nga trupa inspektuese, dënohet me 600 000 lekë gjobë dhe, ministri shfuqizon licencën e trupës së inspektimit të autorizuar.

Trupës së inspektimit, të cilës i hiqet licenca sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni nuk ka të drejtë të kërkojë licencë tjetër për inspektimin e mjeteve ADR.

41. Shfuqizime

Udhëzimi nr. 5, datë 28.05.2012 “Për ekzaminimin dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR”, shfuqizohet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

KREU VI

Tarifat për autorizimin dhe inspektimin e mjetit

42. Tarifat për inspektimet e mjetit ADR

42.1. Vlera e tarifës së shërbimit të shqyrtimit të dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshme

të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të gjitha llojet e mjeteve është 4.000 lekë.

42.2 Vlera maksimale e tarifës së shërbimit për certifikatën ADR për mjetet mbi 3.5 tonë në një trupë inspektimi ADR për çdo mjet është 14.000 lekë.

42.3 Vlera maksimale e tarifës së shërbimit për certifikatën ADR për mjetet e lehta 3.5 tonë e poshtë në një trupë inspektimi ADR për çdo mjet është 9.000 lekë.

42.4 Vlera maksimale e tarifës së shërbimit për certifikatën ADR të tërheqësit të artikuluar për tipin e ri të miratuar 4.000 lekë.

42.5 Vlera maksimale e tarifës së riinspektimit brenda 14 ditëve është 6.000 lekë.

42.6 Vlera e tarifës shërbimit për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR, “ZËVENDËSUESE” është 2.000 lekë.

42.7 Në tarifën e përcaktuara në këtë udhëzim është e përfshirë TVSH-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



SHTOJCA I

Aneksi 1
Formati A4

Logo e DPSHTRR

APLIKIMI PER CERTIFIKIMIN E MJETIT RRUGOR SIPAS ADR

Para plotësimit të këtij aplikimi shiko shënimet në pjesën e pasme. Konsultohuni me këshilltarin Tuaj të sigurisë për mallrave të rrezikshme (Të gjithë pjesët e lidhura me këtë aplikim duhet të plotësohen për të dy rastet si për aplikimin e parë dhe për aplikimet vijuese për të gjithë mjetet)

PJESA 1 (Të plotësohet nga të gjithë aplikuesit)

1. APLIKUESI

EMRI I KONTAKTIT: _____ Nr. Tel: _____

KOMPANIA: _____

ADRESA _____ KODI POSTAL: _____

2. MJETI (Ju lutem shënoni në kutinë e duhur)

A është ky aplikimi i parë për këtë automjet? Po ☐ Jo ☐

Tipi i mjetit	Traktor i artikulluar	☐	I ngurtë	☐
Rimorkio me aks në qendër ☐	Rimorkio e plotë me krah lidhës	☐	Gjysmë-Rimork	☐
A është ky mjet i Lehtë Mallrash d.m.th. TPL 3001 kg deri 3500 kg?			Po ☐	Jo ☐
Metoda e transportimit	Konstruksion (i mbyllur) me Kuti	☐	Skeletore	☐
ose mbajtjes së Ngarkesës	Konstruksion i Veshur me Shtresë	☐	Enë e një mjetit – Bateri	☐
	Cisternë	☐		
	Cisterna fikse			☐
	Cisternë Kontejner /Çmontueshme			☐
	Cisternë/Cisternë e lëvizshme/KGESH			☐
	Mjete cisternë që operojnë nën vakum			☐

Targa e mjetit ose e Rimorkios: _____ Prodhimi Mjetit/Rimorkios _____

Nr. Shasisë Mjetit/ Rimorkios: _____ Nr. i akteve: _____

(bashkëlidhni licencën dhe certifikatën e operimit të mjetit ose rimorkios)

Vetëm për aplikimet e para të mjetit me motor: A e ka mjeti miratimin e tipit sipas ADR? Po ☐ Jo ☐

Nëse po, ju lutem shënoni numrin e miratimit të tipit sipas ADR dhe renditni çdo ndryshim që i është bërë mjetit që nga miratimi i tipit:

Numri ADR T/A _____ Ndryshimet _____

Për cisternat fikse, dhe mjetet – bateri:

Viti i prodhimit: _____ Nr. Cert. TC2 Cert. Nr: _____

Prodhuesi i cisternës: _____ Nr. Serisë së Cisternës: _____

Identifikimi i elementeve - bateri: _____ ose shih listën bashkëngjitur: (shëno) ☐

Kodi i cisternës (ADR 4.3.3.1/4.3.4.1): _____ Dispozitat e speciale (ADR 6.8.4/ shënim 11(e)) _____

**3. PRONARI/OPERATORI I MJETIT (Te plotësohet nga të gjithë aplikuesit)**

KOMPANIA: _____

ADRESA: _____

_____ KODI POSTAL: _____

3.1 Kategoria ADR për të cilën kërkohet

(Lutemi cekoni kutinë e përshtatshëm)

- Certifikata e mjetit ose rimorkios e përdorur në transportin ndërkombëtar ose të brendshëm ☐
- Certifikata e mjetit ose rimorkios e përdorur **vetëm** në transportin e brendshëm ☐

4. INSPEKTIMI TEKNIK

1. Qendra e Inspektimit ADR e preferuar _____ Data/Koha: _____

A synoni të paraqisni mjetin/rimork. të ngarkuar me Mallra të Rrezikshme përveç UN 1202? Po ☐ Jo ☐
Nëse po, qendra e inspektimit do të përgatisë datën dhe kohën e përshtatshme të inspektimit.**5. DEKLARATA E APLIKUESIT**

Unë deklaroj që informacioni i dhënë në këtë formular është i saktë.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Statusi (Menaxher transporti etj.): _____ Data: _____

Metoda e Pagesës:

- Debitoj llogarinë time të Para-paguar: Numri A/C: _____

Emri i të deleguarit: _____ Nënshkrimi i të deleguarit: _____

- Nëse dëshironi të paguani me kartë Krediti/Debiti, personi juridik do të kontaktojë me ju nëpërmjet telefonit për detajet lidhur me pagesën.

Emri i kontaktit: _____ Tel: _____

CERTIFIKATA DUPLIKATË

Nëse ju keni nevojë për një certifikatë dublikate për arsye se certifikata e fundit ka humbur, është vjedhur, është shkatërruar ose është dëmtuar, cekoni në kutinë e duhur.

E humbur ose e Vjedhur ☐ E shkatërruar ☐ E dëmtuar ☐

Data dhe vendi i lëshimit, nëse e dini _____

Shënim: Nëse mjeti tuaj është kontrolluar sipas numri regjistrimi i ndryshëm nga ai i dëshmuari në pikën 2, shkruani numrin e regjistrimit të mëparshëm këtu: _____



PJESA II (Të plotësohet nga të gjithë aplikuesit)

6. KATEGORIA E ADR SIPAS SË CILËS KËRKOHET CERTIFIKIMI

(Ju lutem shënoni kutinë e duhur)

Certifikata sipas **Aneksit 5** të këtij udhëzimi (mjeti motorik ose rimorkion që përdoren në Transportin Ndërkombëtar dhe/ose Brenda Vendit) ☐

Certifikata sipas **Aneksit 6** të këtij udhëzimi (mjeti motorik ose rimorkion që përdoren në Transportin Brenda Vendit) ☐

Kategoria e Mjetit për të cilën certifikata kërkohet

Tipi EX/II Për mjetet me trupë (karroceri) të mbyllur ose mjetet e veshura me shtresë për mbrojtjen e ngarkesës për transportin e lëndëve dhe artikujve eksploziv të klasës 1. ☐

Tipi EX/III Për mjetet me trup (karroceri) të mbyllur e solid i përbërë prej materialesh që nuk digjen menjëherë, të caktuar për transportin e substancave dhe artikujve eksploziv të klasës 1. ☐

Për të gjitha mjetet me lëndë eksplozive të llojit EXII dhe EXII: A synoni të transportoni mallra të grupit “J” të pajtueshmërisë (kompabilitetit)? **Po** ☐ **Jo** ☐

Tipi FL Për mjetet që do të transportojnë lëngje me pikë ndezjeje jo më shumë se 61°C* ose gazet e djegshme me kontejner-cisterna, cisterna të transferueshme ose KGESH (MEGC) me kapacitet më të madh se 3000 litra, cisternat fikse ose cisternat e çmontueshme me kapacitet më të madh se 1000 litra dhe për mjetin me bateri me kapacitet më të madh se 1000 litra të destinuar për transportin e gazeve të ndezshme. ☐

*Duke përjashtuar lëndën e djegshme diesel në përputhje me standardin EN590: 1993, gazoilin dhe vajin ngrohës (të lehtë) sipas UN1202 me pikë ndezjeje sipas përcaktimit në standardin EN590: 1993

Tipi OX Për mjetet e caktuar për transportin e Peroksidit të Hidrogjenit, të stabilizuar ose Peroksidit të Hidrogjenit, tretësirë ujore e stabilizuar me më shumë se 60% Hidrogjen Peroksidi (Klasa 5.1 UN Nr 2015) me kontejnerë-cisterna ose cisterna të transferueshme me kapacitet më të madh se 3000 litra, ose cisterna fikse apo cisterna të çmontueshme me kapacitet më të madh se 1000 litra. ☐

Tipi AT Për mjetet përveç atyre të Llojeve FL ose OX, të caktuar për transportin e mallrave të rrezikshme me kontejnerë-cisternë, cisterna të lëvizshme ose KGESH (MEGC) me kapacitet më të madh se 3000 litra, cisterna fikse apo cisterna të çmontueshme me kapacitet më të madh se 1000 litra dhe për mjetet - bateri me kapacitet më të madh se 1000 litra përveç atyre të Tipit FL. ☐

Për të gjitha cisternat dhe mjetet - bateri: A synoni të transportoni a) hidrogjen? **Po** ☐ **Jo** ☐

b) disulfit karboni? **Po** ☐ **Jo** ☐

A përbëhet cisterna prej materiali plastik të përforcuar? **Po** ☐ **Jo** ☐

MJETI CISTERNE

Deklaroni kodin e cisternës në përputhje me Marrëveshjen ADR 2013, Kapitulli 4.3 (kolona 12, e tabelës A, të Kapitullit 3.2)

Deklaroni kodin e ndonjë Dispozite speciale në lidhje me 6.8.4 të Marrëveshjes ADR 2013, Kapitulli 4.3 (kolona 13, e tabelës A, të Kapitullit 3.2)

**MJETI CISTERNË/MJETI BATERI**

Nëse ndonjë prej substancave që transportohen klasifikohet me shenjë “(+)” në kolonën 12 të Tabelës A në Kapitullin 3.2 të Marrëveshjes ADR 3013

Po ☐ Jo ☐

Nëse po, deklaroni më poshtë emrin e substancës, numrin UN dhe numrin e grupit të paketimit

SUBSTANCA	NUMRI UN	NUMRI I GRUPIT TË PAKETIMIT
SHËNIM:	“Cisterna të çmontueshme” janë cisternat që nuk mund të hiqen nga mjetet transportuese kur janë të ngarkuara. “Cisterna kontejnerë” dhe “cisterna të transferueshme” janë cisternat e modeluara për tu hequr nga mjeti transportues kur janë të ngarkuara për tu kaluar në një mjet tjetër ose mënyrë tjetër transporti. “mjetet - bateri” janë mjetet që kanë një grup depozitash (enë) të ndërlidhura me anë të një kolektori dhe të montuara në mënyrë të përhershme në mjetin përkatës. “KGESH (MEGC) (kontejnerë gazë me elemente të shumëfishë)” janë njësitë që përmbajnë një bateri të elementeve të lidhura së bashku nëpërmjet një kolektori dhe të montuara në një strukturë që mund të hiqet nga mjeti kur ngarkohet.	

7. DOKUMENTACIONI

Së bashku me aplikimin kërkohen dokumentacioni dhe/ose deklaratat e mëposhtme. Mosparaqitja e këtyre dokumenteve mund të vonojë aplikimin. (SHËNIM: Deklaratat për sistemin e frenimit, për shkëmbyesin e nxehtësisë dhe kontrollin e çelësit kryesor nuk kërkohen për mjetet me motor të Tipit të Miratuar sipas ADR, nëse këto sisteme nuk janë ndryshuar pas miratimit të Tipit.)

TIPI EX/II	Sipas rastit, deklaratat e kabinës/trupit, nëse është e aplikueshme deklaratën e mbulesës . Shih pjesët V, VI dhe VIII.			
		N/A	PO	JO
	Deklarata e kabinës e ofruar nga prodhuesi		☐	☐
	Deklarata e mbulesës e ofruar nga prodhuesi	☐	☐	☐
	Deklarata e trupit (karrocerisë)	☐	☐	☐
TIPI EX/III	Deklaratat për sistemin e frenimit, trupin, dhe kontrollin e çelësit kryesor. Shih pjesët III, VI, VII dhe X.			
		N/A	Po	Jo
	Deklarata e frenave e ofruar nga prodhuesi i mjetit	☐	☐	☐
	Deklarata e kabinës e ofruar nga prodhuesi i mjetit		☐	☐
	Deklarata e trupit (karrocerisë) e ofruar nga prodhuesi	☐	☐	☐
	Deklarata e Përshtatshmërisë së Çelësit Kryesor të Baterisë të Cisternës	☐	☐	☐
TIPI FL	Deklaratat e sistemit të frenimit, certifikatat e miratimit të cisternës etj. dhe deklarata e pajisjes ngrohëse. Vërtetimi i qëndrueshmërisë. Deklarata e kontrollit të çelësit kryesor. Shih pjesët III, IV, VIII, IX dhe X..			



		N/A	PO	JO
	Deklarata e frenave e ofruar nga prodhuesi i mjetit	☐	☐	☐
	Certifikata e miratimit të Tipit të Cisternës	☐	☐	☐
	Kodi i Cisternës dhe/ose Lista e prodhimit të ofruar		☐	☐
	Certifikata e Miratimit Fillestar të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kontrollit Periodik të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kontrollit të Hermeticitetit të Cisternës	☐	☐	☐
	Deklarata e Shkëmbyesit të Nxhtësisë	☐	☐	☐
TIPI OX	Deklarata e Frenimit, Certifikatat e Miratimit të Cisternave dhe Deklarata Shkëmbyesit të Nxhtësisë. Shih pjesët III, IV, VIII, IX dhe X.			
		N/A	PO	JO
	Deklarata e frenave e ofruar nga prodhuesi i mjetit	☐	☐	☐
	Certifikata e Tipit të Cisternës	☐	☐	☐
	Kodi i Cisternës dhe/ose Lista e prodhimit të ofruar		☐	☐
	Certifikata e Miratimit Fillestar të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kontrollit Periodik të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kontrollit të Hermeticitetit të Cisternës	☐	☐	☐
	Deklarata e kabinës e ofruar nga prodhuesi i mjetit	☐	☐	☐
TIPI AT	Deklaratat e sistemit të frenimit dhe certifikatat e miratimit të cisternës etj. Deklarata e pajisjes ngrohëse. Vërtetimi i qëndrueshmërisë. Shih pjesët III, IV, VIII, IX.			
		N/A	PO	JO
	Deklarata e frenave e ofruar nga prodhuesi i mjetit	☐	☐	☐
	Certifikata e Tipit të Cisternës	☐	☐	☐
	Kodi i Cisternës dhe/ose Lista e prodhimit të ofruar	☐	☐	☐
	Certifikata e Miratimit Fillestar të Cisternës		☐	☐
	Certifikata e Kontrollit Periodik të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kontrollit të Hermeticitetit të Cisternës	☐	☐	☐
	Certifikata e Kushteve Vjetore të Veshjes së Cisternës (e kërkuar Vetëm nëse transporton Bromine)	☐	☐	☐

PJESA III

8. KËRKESAT PËR SISTEMIN E FRENIMIT PËR MJETET E TIPEVE EX/III, FL, OX DHE AT

Deklarata e sistemit të frenimit, e plotësuar nga prodhuesi kërkohet për disa mjete që nuk plotësojnë miratimin e tipit sipas ADR në momentin e aplikimit të parë për inspektimin ADR. Këto mjete janë:



a) mjeti motorik me masë maksimale që e kalon 16 tonë;

b) mjeti motorik i autorizuar për të tërhequr rimorkio të plotë me krah lidhës me masë maksimale që e kalon 10 tonë, ose rimorkio me bosht në qendër apo gjysmë – rimorkio me peshë për aks më shumë se 10 tonë;

c) rimorkio e plotë me krah lidhës me masë maksimale që e kalon 10 tonë, ose rimorkio me bosht në qendër apo gjysmë - rimorkio me masë maksimale që e kalon 10 tonë.

Mjetet e regjistruara para 1 Prillit 2002 dhe kërkojnë certifikatën vetëm për Transport Brenda Vendit (shiko Aneksin 6, të shtojcës I) që nuk janë të përshtatur me sistemin anti-blokalizim dhe sistemin e frenimit nuk kërkojnë një deklaratë frenimi.

DEKLARATË – të plotësohet nga prodhuesi. Deklaratat e Tregtarit nuk pranohen.

SHËNIM: Nga prodhuesi pranohet një deklaratë më vete me kusht që kjo deklaratë t'i përkasë mjetit në fjalë.

Unë deklaroj që:

- Në rastin e mjetit të përmendur në (a) ose (b) më lart, automjeti është i pajisur me sistemin e frenimit kundër bllokimit të kategorisë 1 sipas Nenit Nr. 13, të ECE, Aneksi 13 ose sipas Direktivës 71/320/EEC
- Gjithashtu mjeti është i pajisur me pajisjen e ngadalësimit të frenimit, që plotëson kërkesat e Nenit Nr. 13, të ECE, Aneksi 5 me peshën e automjetit të ngarkuar që përbëhet nga pesha e ngarkesës së mjetit me motor dhe peshës maksimale të rimorkuar të autorizuar por që nuk është më shumë se 44 ton.
- Në rastin e rimorkios të përmendur në (c) më lart, rimorkio është i pajisur me sistemin e frenimit kundër bllokimit të kategorisë A sipas Nenit Nr. 13, të ECE, Aneksi 13 ose sipas Direktivës 71/320/EEC.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

Deklarata e mëposhtme kërkohet nga çdo zotërues për çdo aplikim sipas ADR në lidhje me llojet e mjeteve të përmendura më lart të cilat aktualisht ose më parë kanë dhënë deklaratën e sistemit të frenimit të prodhuesit ose miratimit të tipit.

DEKLARATË- të plotësohet nga zotëruesi (pronari)

Unë deklaroj që nuk është bërë asnjë riparim apo ndryshim që mund të zhvlerësojë deklaratën e prodhuesit ose miratimin e llojit të mjetit sipas ADR që mund të ndikojë në funksionimin e:

a. sistemit të frenimit kundër bllokimit, ose

b. sistemi i rezistencës frenimit

Vetëm për mjetet me motor:- Masa maksimale e automjetit është _____ kg; masa maksimale e rimorkios ose gjysmë-rimorkios është _____ kg.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

**PJESA IV****9. CERTIFIKATAT E CISTERNAVE ETJ. (VETËM PËR CISTERNAT DHE MJETET – BATERI)**

Normalisht sëbashku me aplikimin, aplikuesi duhet të ofrojë dokumentet e mëposhtme: (Pranohen kopjet, por dokumentet origjinale duhet të paraqiten ditën e inspektimit)-

- a) Certifikata e miratimit të tipit të cisternës
- b) Listën e Prodhimit të Cisternës dhe/ose Kodi i Cisternës (vetëm aplikimi i parë nëse lista nuk ka ndryshuar)
- c) TC2 ose TV6 Numri i Certifikatës së Miratimit Fillestar të Cisternës _____
- d) TC3 ose TV8 Numri i Certifikatës së Inspektimit Periodik të Cisternës _____
- dh) Certifikata Vjetore e Gjendjes së Veshjes së Cisternës (kërkohet vetëm nëse transporton Bromine)

Të dhënat e mëposhtme nuk janë nxjerrë akoma por do të paraqiten ditën e inspektimit: (shih shënimin, pika 11 (b)).

PJESA V**10. DEKLARATA E MBULESËS PËR MJETET E LLOJIT EX/II TË VESHURA ME SHITRESË PËR MBROJTEN E MALLIT**

Kjo deklaratë duhet të plotësohet nga prodhuesi ose ofruesi i automjetit apo mbulesës. **SHËNIM:** prodhuesi ose ofruesi i mjetit ose i mbulesës mund të paraqesë një deklaratë me vete nëse ka të bëjë me mjetin.

Unë deklaroj që mbulesa (shtresa mbrojtëse) e prodhuar ose ofruar nga _____ dhe sipas rastit e shënuar me të dhënat e mëposhtme të identifikimit: _____ është prej materiali të padepërtueshëm dhe që nuk digjet menjëherë vërtetuar nëpërmjet testimit të nivelit B1 në standardin DIN 4102 ose ekuivalent me të: BS5438, BS7837 ose DIN 75200 pranohet, me normë djegieje jo më shumë se 100 mm/min sipas testimit në përputhje me ISO 3795:1989.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

DEKLARATË – të plotësohet nga pronari/operatori

Unë deklaroj që mbulesa e përdorur është e njëjtë me atë të vitit të kaluar dhe nuk është zëvendësuar apo ndryshuar në mënyrë të tillë që të zhvlerësojë automjetin origjinal ose deklaratën e prodhuesit apo ofruesit për mbulesën. Nëse mbulesa është ndryshuar ju lutem merrni deklaratën më lart nga prodhuesi ose ofruesi i automjetit apo mbulesës.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

**PJESA VI****11. DEKLARATA E KABINËS PËR TË GJITHA MJETET EXII DHE EXIII DHE ATO OX TË PA-PAJISURA ME MBUROJË METALIKE PAS KABINËS.**

Deklarata e plotësuar nga prodhuesi kërkohet në momentin e aplikimit të parë për kontrollin sipas ADR për të gjitha mjetet OX që nuk kanë mburojë metalike pas kabinës.

- a. Tipi EXII (eksplozivë);
- b. Tipi EXIII (eksplozivë);
- c. Tipi OX nëse nuk pajiset me një pllakë mbrojtëse mbrapa.

DEKLARATË – të plotësohet nga prodhuesi (ose modifikuese, nëse aplikohet). Deklaratat e Tregtarit nuk pranohen.

SHËNIM: Nga prodhuesi pranohet një deklaratë më vete me kusht që kjo deklaratë t'i përkasë mjetit në fjalë.

Unë deklaroj që në ndërtimin e kabinës së drejtuesit janë përdorur vetëm materiale që nuk digjen menjëherë.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

Deklarata e mëposhtme kërkohet nga zotëruesi për çdo aplikim sipas ADR në lidhje me llojin e automjetit të përmendur më lart.

DEKLARATË – të plotësohet nga zotëruesi/tregtari ofrues

Unë deklaroj që nuk është bërë asnjë riparim, ndryshim apo lyerje e kabinës në mënyrë të tillë që të zhvlerësojë deklaratën e prodhuesit.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

PJESA VII**12. DEKLARATA PËR TRUPIN (KONSTRUKSIONIN) E MJETEVE TË TIPIT EX/III**

Deklarata e plotësuar nga prodhuesi kërkohet në momentin e aplikimit të parë për kontrollin sipas ADR.

DEKLARATË – të plotësohet nga prodhuesi/konstruktori i trupit ose ofruesi të mjetit.

SHËNIM: Nga prodhuesi pranohet një deklaratë më vete me kusht që kjo deklaratë t'i përkasë mjetit në fjalë.

Unë deklaroj që në rastin e mjetit motorik të Tipit EX/III ose rimorkios të përdorur për herë të parë para datës 1 Korrik 2005:

- Trupi i mjetit është i ndërtuar në mënyrë solide prej materialesh që nuk digjen menjëherë dhe materiale të përdorura për veshjen nuk mund të prodhojnë shkëndija.
- Vetitë izoluese dhe rezistuese ndaj nxehtësisë së trupit janë të paktën të njëjta me ato të ndarjes që përbëhet nga një parë i jashtëm metalik të veshura me një shtesë druri rezistent ndaj zjarrit me trashësi 10mm, ose trupi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që nuk lejon depërtimin e flakës në parë ose



vendet e nxehta me temperature më shumë se 120°C në sipërfaqen e paretit të brendshëm mund të ndizen brenda 15 minutave nga fillimi i zjarrit që mund të shkaktohet nga funksionimi i mjetit.

- Në ndërtimin e trupit të mjetit nuk është përdorur asnjë material që mund të krijojë përbërje të rrezikshme me lëndët e transportuara.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

Unë deklaroj që në rastin e mjetit motorik të Tipit EX/III ose rimorkios të përdorur për herë të parë më 1 Korrik 2005 ose pas kësaj datë:

- Materialet e përdorura për veshjen nuk mund të prodhojnë shkëndija.
- Materialet e përdorura për trupin dhe veshjen e tij përbëhen prej materialeve rezistente ndaj nxehtësisë dhe flakës me trashësi të paktën 10 mm dhe që janë në përputhje me klasifikimin B-S₃-d₂ të EN 13501-1:2002.
- Në ndërtimin e trupit (karrocerinë) të automjetit nuk është përdorur asnjë material që mund të krijojë përbërje të rrezikshme me lëndët e transportuara.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

DEKLARATË – të plotësohet nga pronari.

Unë deklaroj që asnjë riparime, modifikime ose lyerje (bojatisje) të trupit (karrocerisë) janë kryer në mënyrë të tillë që të zhvlerësojë deklaratën e prodhuesit.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____

PJESA VIII

13. DEKLARATA PËR SHKËMBYESIN E NXEHTËSISË

(zbatohet për të gjithë mjetet sipas ADR që kanë përdorur për herë të parë shkëmbyesin e nxehtësisë pas datës 30 Qershor 2005)

Deklarata kërkohet në momentin e aplikimit të parë për kontrollin sipas ADR për mjetet e përcaktuara më lart që nuk janë subjekt i Miratimit të Tipit sipas ADR ose që kanë ndryshuar sistemin e pajisjes ngrohëse pas Miratimit të Tipit.

DEKLARATË – të plotësohet nga prodhuesi i mjetit të plotësuar ose i shkëmbyesit të nxehtësisë ose instaluesi.

SHËNIM: Pranohet deklaratë më vete me kusht që t'i përkasë mjetit.

Për mjetet që janë përdorur për herë të parë më, ose pas datës 1 Korrik 2005, Unë deklaroj që instalimi i saj është në përputhje me kërkesat teknike përkatëse të Direktivës 2001/56/EC e ndryshuar.

Gjithashtu për mjetin me motor të tipit FL deklaroj se shkëmbyesi i nxehtësisë të pajisjes ngrohëse është rezistent ndaj ciklit të reduktuar prej 40 sekondash pas vënies në punë për kohën e përdorimit të tij normal.

Nënshkroi: _____ Emri: (SHKRONJA KAPITALE): _____

Kompania: _____ Statusi: _____ Data: _____



SHËNIME

TË PËRGJITHSHME

H.38					9.2.4.6	Automjetet e pajisura me sistemin e frenimit të rezistencës që çliron temperatura të larta, i vendosur pas anës së pasme të kabinës së shoferit duhet të pajiset me mburojë termike të siguruar dhe të vendosur në mënyrë të sigurt ndërmjet këtij sistemi dhe depozitës ose ngarkesës në mënyrë të tillë që të shmangë nxehtësinë, qoftë edhe lokale të paretit të depozitës ose ngarkesës.	B		
H.39					9.2.4.6	Mburoja termike duhet të mbrojë sistemin e frenimit kundër rrjedhjes ose pikimit, qoftë edhe aksidentale, të ngarkesës. Për shembull, mund të konsiderohet e kënaqshme mburoja që përfshin mburojën me dy parete (e dubluar).	B		
					9.2.4.7	Ngrohje me djegie			
H.40					9.2.4.7.1	Ngrohja me djegie duhet të plotësojë kërkesat teknike përkatëse të Nenit Nr. 122 ⁵ të ECE, i ndryshuar, ose të Direktivës 2001/56/EC ⁶ , e ndryshuar, në përputhje me datat e zbatimit të përcaktuara për këtë qëllim dhe me dispozitat e 9.2.4.7.2 deri në 9.2.4.7.6 të zbatueshme sipas tabelës në 9.2.1*.	A		
H.41					9.2.4.7.2	Ngrohja me djegie dhe rrugët e tyre të shkarkimit të gazit duhet të projektohen, vendosen mbrohen ose mbulohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë çdo rrezik të papranueshëm të nxehtësie ose ndezjes së ngarkesës*. Kjo kërkesë duhet të konsiderohet e plotësuar nëse depozita e karburantit dhe sistemi i shkarkimit të pajisjes janë në përputhje me dispozitat e ngjashme me ato të përshkruara për depozitat e karburantit dhe sistemet e shkarkimit të automjeteve respektivisht në 9.2.4.3 dhe 9.2.4.5.	A		
H.42					9.2.4.7.3	Ngrohja me djegie duhet të vihet jashtë funksionit të paktën me metodat e mëposhtme: (a) Fikja manuale e qëllimshme nga kabina e shoferit; (b) Ndalimi i motorit të automjetit; pajisja ngrohëse mund të rindizet në mënyrë manuale nga shoferi; (c) Ndezja e pompës së furnizimit për automjetin me motor për mallrat e rrezikshme të transportuara.	A		
H.43					9.2.4.7.4	Funksionimi pas fikjes së motorit lejohet ngrohja me djegie jashtë funksionit*. Për metodat e 9.2.4.7.3 (b) dhe (c), furnizimi i ajrit të ngrohtë ndërpritet me anë të masave të përshtatshme pas ciklit të funksionimit, pas fikjes së motorit, prej jo më shumë se 40 sekondash. Vetëm ngrohësit duhet të përdoren për të cilët është vërtetuar se shkëmbyesi i nxehtësisë është rezistent ndaj ciklit të	A		

⁵ Neni Nr. 122 I ECE (Neni lidhur me miratimin e llojit të sistemit ngrohës dhe të automjetit përsa I përket sistemit të tij ngrohës).

⁶ Direktiva 2001/56/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 27 Shtator 2001 lidhur me sistemin ngrohës për automjetet me motor dhe rimorkiot e tyre (fillimisht publikuar në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Europian Nr. L292 datë 9 Nëntor 2001).



						pakësuar të funksionimit prej 40 sekondash pas fikjes së motorit për kohën e përdorimit të tyre normal.				
H.44					9.2.4.7.5	Ngrohja me djegie duhet të ndizet në mënyrë manuale*. Pajisjet programuese ndalohen.		A		
H.45					9.2.4.7.6	Ngrohja me djegie me lëndë djegëse të gaztë nuk lejohen.		A		
					9.2.5	Pajisja e kufizimit të shpejtësisë				
H.47					9.2.5	Automjetet me motor (automjetet me dy boshte dhe traktorët për gjysmë-rimorkiot) me masë maksimale që tejkalon 3.5 ton, duhet të pajisen me pajisjen e kufizimit të shpejtësisë në përputhje me kërkesat teknike të Nenit Nr. 89 ⁷ të ECE, i ndryshuar.*		D		
H.46					9.2.5	Pajisja duhet të vendoset në mënyrë të tillë që shpejtësia të mos tejkalojë 90 km/h, duke marrë parasysh tolerancën teknologjike të pajisjes.		D		
					9.2.6	Pajisjet bashkuese të rimorkiove				
H.47					9.2.6	Pajisjet bashkuese të rimorkiove duhet të plotësojnë kërkesat e Rregullores Nr. 55 ⁸ të ECE ose Direktivës 94/20/EC ⁹ , e ndryshuar në përputhje me datat e zbatimit të përcaktuara për këtë qëllim.		D		

Shënime për pjesët I dhe J (shih gjithashtu udhëzimet në fund të këtij Aneksi)

— **Kolona D** shërben për të vlerësuar vizatimin e automjetit në lidhje me përmbushjen e normave, ndërsa kolona E për të vlerësuar gjendjen

— Në kolonën **D**, në rastet kur normativat është e aplikueshme, ndiq atë çka rekomandohet nga instruksionet në fund, duke shënuar me një **“Po”** nëse e plotëson normën dhe me **“Jo”** nëse nuk e plotëson normën. Nëse norma nuk është e aplikueshme vihet një vizë.

— Në kolonën **E**, trego (shëno) me një **“Po”** nëse e plotëson normën dhe me **“Jo”** nëse nuk e plotëson normativën. Nëse norma nuk është e aplikueshme vihet një vizë.

— Në kolonën **N°** i Certifikatës, shëno numrin e saj në rastet kur kërkohet

⁷ Neni Nr. 89 I ECE: Dispozitat uniforme lidhur me miratimin e:

- I. Automjetet në lidhje me kufizimin e shpejtësisë së tyre maksimale;
- II. Automjetet në lidhje me instalimin e pajisjes së kufizimit të shpejtësisë (SLD) të llojit të miratuar;
- III. Pajisjet e kufizimit të shpejtësisë (SLD).

Në mënyrë alternative, mund të zbatohen dispozitat korresponduese të direktivës 92/24/EEC të Këshillit datë 31 Mars 1992 (publikuar në versionin origjinal në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Europian Nr. L129 datë 14.05.1992), e ndryshuar, me kusht që këto dispozita të jenë ndryshuar në përputhje me formën më të fundit të ndryshuar të Nenit Nr. 89 të ECE të zbatueshme në kohën e miratimit të automjetit.

⁸ Neni Nr. 55 I ECE (Dispozitat uniforme lidhur me miratimin e përbërësve mekanikë bashkues të kombinimeve të automjeteve)

⁹ Direktiva 94/20/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 30 Maj 1994 (publikuar në versionin origjinal në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Europian Nr. L195 datë 29.07.1994).



Logo e DPSHTRR

**I. KERKESA SHITESË NË LIDHJE ME MJETET E PLOTË OSE TË PLOTËSUAR
EX/II OSE EX/III PËR TRANSPORTIN E SUBSTANCAVE EKSPLOZIVE DHE
MATERIALEVE (KLASA 1) NË PAKETA.**

Nr.	ADR	NORMA	D	E	Nr. CERTIFIK
	9.3.1	Materiale që do të përdoren në ndërtimin e trupit të automjetit			
L1	9.3.1	Në ndërtimin e trupit (karrocerisë) të automjetit nuk duhet të përdoret asnjë material që mund të formojë përbërës të rrezikshëm me lëndët eksplozive që transportohen.	K		
	9.3.2	Ngrohja me djegie			
L2	9.3.2.1	Ngrohësi me djegie instalohet në mjetet EX/II ose EX/III për ngrohjen e kabinës së drejtuesit ose motorit të mjetit.	N		
L3	9.3.2.2	Ngrohja me djegie duhet të plotësojnë kërkesat e seksioneve 9.2.4.7.1, 9.2.4.7.2, 9.2.4.7.5 dhe 9.2.4.7.6.	I		
L4	9.3.2.3	Çelësi (ndërprerësi) i ngrohësit me djegie të instalohet jashtë kabinës së shoferit. Nuk është e nevojshme për të vërtetuar se shkëmbyesi i nxehjes është rezistent ndaj ciklit të zvogëluar të funksionimit pas fikjes së motorit.	I		
L5	9.3.2.4	Në kompartimentin e ngarkesës nuk duhet të instalohet asnjë ngrohës me djegie ose depozitë karburanti, burim energjie, ose futje ajrit të djegies ose ajrit ngrohës si dhe daljet e tubave të shkarkimit të nevojshme për funksionimin e ngrohësit me djegie.	N		
	9.3.3	Mjetet EX/II			
L6	9.3.3	Mjetet janë projektuar, konstruktuar dhe pajisur në mënyrë të tillë që lëndët eksplozive të mbrohen nga rreziqet e jashtme dhe moti.	N		
L7	9.3.3	Blindimi duhet të jetë rezistent ndaj shqitjes dhe prej materiali të papërshkueshëm, që nuk ndizet menjëherë ¹⁰ . Blindimi duhet të jetë i tendosur në mënyrë që të mbulojë në të gjitha anët sipërfaqen e ngarkimit.	N		
L8	9.3.3	Shkalla e djegies së tendës në përputhje me procedurat e specifikuar në ISO 3795:1989 nuk duhet t'i kalojë shpejtësinë 100mm/min.	F		
L9	9.3.3	Të gjitha hyrjet në kompartimentin e ngarkesës së mjeteve të mbyllura duhet të kenë dyer që mund të kyçen, që puthiten mirë ose kapakë të palëvizshëm	N		
L10	9.3.3	Kompartimenti i shoferit duhet të ndahet nga kompartimenti i ngarkesës nga një paret (mur) i pandërprerë.	N		
	9.3.4	Mjetet EX/III			
L11	9.3.4.1	Mjetet janë projektuar, konstruktuar dhe pajisur në mënyrë të tillë që lëndët eksplozive të mbrohen nga rreziqet e jashtme dhe moti.	N		
L12	9.3.4.1	Automjeti është i mbyllur.	N		
L13	9.3.4.1	Kompartimenti i shoferit duhet të ndahet nga kompartimenti i ngarkesës nga një paret (mur) i pandërprerë	N		
L14	9.3.4.1	Sipërfaqja e ngarkimit duhet të jetë e pandërprerë (e vazhdueshme).	N		
L15	9.3.4.1	Gjithashtu instalohen pikat e ankorimit për shtërgimin e ngarkesës.	N		
L16	9.3.4.1	Të gjitha lidhjet duhet të jenë të puthitura dhe të gjitha hapjet (vrimat) të jenë të bllokua (mbimbuluara).	N		
L17	9.3.4.1	Dyert bllokohen të gjitha.	N		
L18	9.3.4.1	Nyjet e dyerve janë të mbyllura.	N		
L19	9.3.4.2	Materiali i trupit (karrocerisë) është i qëndrueshëm ndaj ngrohjes (nxehjes) dhe zjarrit dhe ka trashësinë minimale prej 10 mm. Konsiderohet se kjo dispozitë kënaqet kur materiali që përdoret është i Klasës B-s3-d2 dhe në përputhje me standardin EN 13501-1: 2002.	F		
L20	9.3.4.2	Nëse materiali i përdorur për trupin e automjetit është metal, pjesa e brendshme e përfunduar e trupit duhet të mbulohet me materiale që plotësojnë të njëjtën kërkesë, Klasën B-s3-d2 dhe në përputhje me standardin EN 13501-1: 2002 për të plotësuar këtë kërkesë.	F		
	9.3.5	Motori dhe kompartimenti i ngarkesës për mjetet EX/II dhe EX/III			
L21	9.3.5	Motori që vë në lëvizje automjetin EX/II ose EX/III duhet të vendoset përpara murit (paretit) të përparmë të kompartimentit të ngarkesës.	N		
L22	9.3.5	Nëse motori vendoset poshtë kompartimentit të ngarkesës, duhet që të vendoset në	N		

¹⁰ Në rastin e ndeshmërtisë, kjo kërkesë çmohet se është plotësuar nëse, në përputhje me procedurën e përcaktuar në standardin e ISO 3795:1989 "automjetet rrugore, traktorët dhe makinat për bujqësi dhe pyje – Përcaktimi i sjelljes djegëse të materialeve të brendshme", mostrat e blindimit kanë një normë djegëse që nuk tejkalon 100mm/min.



		mënyrë të tillë që nxehja e tepërt të mos përbëjë rrezik për ngarkesën duke e ngritur temperaturën në sipërfaqen e brendshme të kompartimentit të ngarkesës mbi 80°C.			
	9.3.6	Burimet e jashtme të nxehtësisë dhe kompartimenti i ngarkesës për mjetet EX/II dhe EX/III			
I.23	9.3.6	Sistemi i shkarkimit të automjeteve EX/II dhe EX/III ose pjesëve të tjera të këtyre automjeteve të përfunduara në një fazë ose në disa faza duhet të ndërtohet dhe të vendoset në mënyrë të tillë që çdo nxehje e tepërt të mos përbëjë rrezik për ngarkesën duke e rritur temperaturën në sipërfaqen e brendshme të kompartimentit të ngarkesës mbi 80°C.	N		
	9.3.7	Pajisjet elektrike			
I.24	9.3.7.1	Voltazhi i vlerësuar nuk duhet të kalojë 24V.	N		
I.25	9.3.7.2	Çdo ndriçim në kompartimentin e ngarkesës së automjeteve EX/II duhet të jetë në tavan dhe i mbuluar, d.m.th pa bulb ose përcjellës të zbuluar (eksponuar).	N		
I.26	9.3.7.2	Në rastin e Grupit të Përputhjes J, instalimi elektrik duhet të jetë të paktën IP65 (p.sh. Eex d rezistent ndaj zjarrit).	N		
I.26	9.3.7.2	Çdo pajisje elektrike e aksesueshme nga pjesa e brendshme e kompartimentit të ngarkesës duhet të mbrohet në mjaftueshmërisht nga ndikimi mekanik nga brenda.	N		
I.27	9.3.7.3	Instalimi elektrik në automjetet EX/III duhet të përmbushë kërkesat përkatëse të 9.2.2.2; 9.2.2.3; 9.2.2.4; 9.2.2.5 dhe 9.2.2.6 të ADR.	I		
I.28	9.3.7.3	Në automjetin EX/III, instalimi elektrik në kompartimentin e ngarkesës duhet të mbrohet nga pluhuri (të paktën IP54 ose ekuivalent me të) ose, në rastin e Grupit J të Përputhjes, të paktën IP65 (p.sh. Eex d rezistent ndaj zjarrit).	N		
I.29	9.3.7.3	Në automjetin EX/III, instalimi elektrik në kompartimentin e ngarkesës, në rastin e Grupit J të Përputhjes, duhet të mbrohet nga pluhuri, me një shkallë të paktën IP65 (p.sh. Eex d rezistent ndaj zjarrit).	H		



Logo e DPSHTRR

**J. KËRKESA SHITESË NË LIDHJE ME CISTERNAT FIKSE, MJETET – BATERI
DHE MJETET E PLOTË OSE TË PLOTËSUAR TË PËRDORUR PËR
TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME NË CISTERNAT TË
ÇMONTUESHME ME NJË KAPACITET MË TË MADH SE 1 M³ (MJETET EX/III,
FL, OX, DHE AT)**

Nr.	ADR	NORMË/URDHËR/PARASHKRIMI	D	E	Nr. CERT.
	9.7.2	Dispozitat në lidhje me cisternat			
J.1	9.7.2.1	Në rastin e cisternave fikse ose të çmontueshme të prodhuara prej metali do të plotësohen kërkesat përkatëse të kapitullit 6.8 të ADR.	N		
J.2	9.7.2.2	Elementët e mjetit – bateri dhe KGESH (MEGCs) do të plotësojnë kërkesat përkatëse të kapitullit 6.2 të ADR në rastin e cilindrave (bombolave), tubave, rezervuarëve nën presion dhe tufave (vandakëve) të cilindrave (bombolash)	N		
J.3	9.7.2.4	Cisternat me material plastik prej fibre të përforcuar do të plotësojnë kërkesat e kapitullit 6.9 të ADR.	N		
J.4	9.7.2.5	Cisternat e mbeturinave që operojnë nën vakum do të plotësojnë kërkesat e kapitullit 6.10 të ADR.	N		
	9.7.3	Mjetet e fiksimit			
J.5	9.7.3	Mjetet e fiksimit do të projektohen për të përballuar tensione statike dhe dinamike në kushtet normale të transportit, dhe tensioni minimal siç përcaktohet në 6.8.2.1.2, 6.8.2.1.11 deri në 6.8.2.1.15 dhe 6.8.2.1.16 të ADR në rastin e mjeteve – cisternë, mjeteve – bateri, dhe mjeteve që mbartin cisterna të çmontueshme.	I		
	9.7.4	Tokëzimi i mjeteve FL			
J.6	9.7.4	Cisternat e prodhuara prej materiali metalik ose plastik me fibër të përforcuar të mjetit cisternë FL dhe elementëve të mjetit – bateri FL do të lidhen me shasinë me anën e të paktën një lidhje të mirë elektrike.	N		
J.7	9.7.4	Çdo kontakt metalik i aftë të shkaktoj korrozion elektrokimie duhet të shmanget. SHËNIM: Shiko gjithashtu 6.9.1.2 dhe 6.9.2.14.3	N		
	9.7.5	Stabiliteti i mjetit - cisternë			
J.8	9.7.5.1	Gjerësia e përgjithshme e sipërfaqes mbështetëse në nivelin të nivelit tokësor (distanca ndërmjet pikave të jashtme të kontaktit me tokën e gomës së anës së djathtë dhe gomës së majtë të të njëjtit aks do të jetë të paktën te 90% e lartësisë së qendrës së gravitetit të mjetit – cisternë të ngarkuar.	I		
J.9	9.7.5.1	Në mjetin e artikuluar, masa mbi akset e njësisë ngarkesë - mbajtëse e gjysmë-rimorkios me ngarkesë nuk duhet të kalojë 60% të masës së përgjithshme nominale me ngarkesë të mjetit të plotë të artikuluar.	I		
J.10	9.7.5.2	Veç kësaj, mjetet –cisternë me cisterna të fiksuara me një kapacitet më të madh se 3 m ³ të destinuar për transportin e mallrave të rrezikshme në gjendje të lëngshme ose të shkrirë me një presion më të vogël se 4 bar, duhet të përputhen me kërkesat teknike të Rregullores ECE 111 ¹ për stabilitetin anësor, siç është amenduar, në përputhje me datën e zbatimit të specifikuara këtu. Kërkesat janë të zbatueshme për mjetet – cisternë të cilat janë të regjistruar për herë të parë nga 1 Qershori 2003.	L		
	9.7.6	Mbrojtja e pasme e mjetit			
J.11	9.7.6	Një parakolp mjaft rezistent ndaj goditjeve te pasme do të vendoset mbi gjerësinë e plotë të cisternës në pjesën e pasme të mjetit.	N		
J.12	9.7.6	Do të ketë një hapësirë prej të paktën 100 mm midis murit të pasmë të cisternës dhe pjesës së pasme të parakolpit (kjo hapësirë të jete e matur nga pika më e largët e murit të cisternës ose nga projektimi i montimeve ose aksesorëve që janë në kontakt me substancën që po mbartet). Automjetet me një depozitë anësore për transportin e substancave pluhur ose të grimcuara dhe një cisternë e mbeturinave që operon me thithje (ose me vakum) me një rezervuar (depozitë) anësore me shkarkim të pasëm nuk kane nevojë për një parakolp nëse montimet anësore te depozitës janë të pajisur me një mjet mbrojtës i cili e mbron këtë të fundit (pra depozitën) në të njëjtën mënyrë si parakolpi. SHËNIM 1: Kjo dispozitë nuk zbatohet për mjetet që përdoren për transportin e mallrave të rrezikshme në cisterna - kontejnerë, KGESH (MEGCs) ose cisterna portabile (të transferueshme).	N		



		SHËNIM 2: Për mbrojtjen e cisternave kundër dëmtimeve nga goditjet anësore apo edhe pëmbysjeve, shiko seksionet 6.8.2.1.20 dhe 6.8.2.1.21, ose, për cisterna portabile (të transferueshme), 6.7.2.4.3 dhe 6.7.2.4.5 të ADR.			
	9.7.7	Ngrohësit me djegie			
J.13	9.7.7.1	Pajisja ngrohëse me djegie kënaq kërkesat e seksioneve 9.2.4.7.1, 9.2.4.7.5 të ADR dhe kërkesat e mëposhtme: (a) çelësi duhet të instalohet jashtë kabinës së drejtuesit të mjetit; (b) pajisja duhet të mbyllet nga jashtë kompartimentit ku ndodhet ngarkesa; dhe (c) nuk është e nevojshme të provoj që shkëmbyesi i nxehtësisë është rezistent ndaj reduktimit të ciklit pasardhës.	I		
J.14	9.7.7.1	Veç kësaj, për mjetet FL, duhet të plotësojnë kërkesat e seksioneve 9.2.4.7.3 dhe 9.2.4.7.4 të ADR	I		
J.15	9.7.7.2	Nëse automjeti do të përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme për të cilat parashikohet emërtimi në përputhje me modelet Nr.1.5, 3, 4.1, 4.3, 5.1 ose 5.2, në kompartimentin e ngarkesës nuk duhet të instalohet asnjë radiator djegieje ose depozitë me karburant, burim energjie, tubat e ajrit të djegies ose ajrit ngrohës si dhe daljet e tubave të shkarkimit të nevojshme për funksionimin e ngrohësit me djegie.	N		
J.16	9.7.7.2	Duhet të sigurohet që dalja e ajrit të ngrohës nuk duhet të bllokohet nga ngarkesa. Temperatura e ngrohjes së ngarkesës nuk duhet të kalojë 50° C.	N		
J.17	9.7.7.2	Pajisjet e ngrohjes të montuara brenda kompartimenteve të ngarkesës duhet projektohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë ndonjë atmosferë ndezje ose shpërthimi që mundësohet gjatë kushteve të operimit.	H		
	9.7.8	Pajisje elektrike			
J.18	9.7.8.1	Në rastin e mjeteve FL për të cilin miratimi në përputhje me seksionin 9.1.2 të ADR kërkohet , duhet të plotësohen kërkesat e seksioneve 9.2.2.2, 9.2.2.3, 9.2.2.4 dhe 9.2.2.6 të ADR. SHËNIM: Për dispozitat transitorë shiko gjithashtu seksionin 1.6.5 të ADR	N		
J.19	9.7.8.1	Në rastin e mjeteve FL për të cilin miratimi në përputhje me seksionin 9.1.2 të ADR kërkohet , duhet të plotësohen kërkesat për instalimet elektrike për mjetin e plotë ose të plotësuar, duke përfshirë cisternat sipas dispozitave të seksionit 9.2.2.5.1 të ADR. SHËNIM: Për dispozitat transitorë shiko gjithashtu seksionin 1.6.5 të ADR	H		
J.20	9.7.8.1	Megjithatë shtesat ose modifikimet e instalimeve elektrike për mjetin duhet të plotësojnë kërkesat për aparaturat elektrike të grupit përkatës dhe klasën e temperaturës në përputhje me substancat që mbarten.	H		
J.21	9.7.8.2	Pajisja elektrike për mjetet FL, të gjendura në zonat ku ka atmosferë eksplozive, ose që mund të pritet të jetë prezent në sasi të tilla që kërkojnë masa paraprake të veçanta, duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në një zonë të rrezikshme. Pajisje e tillë do të plotësojë kërkesat e përgjithshme të IEC 60079 pjesët 0 dhe 14 dhe kërkesat shtesë të aplikueshme nga IEC 60079 pjesët 1, 2, 5, 6, 7, 11 ose 18. Kërkesat për aparatet elektrike të grupit përkatës dhe klasës së temperaturës do të plotësohen në përputhje me substancat që mbarten. Për zbatimin e IEC 60079 pjesa 14, klasifikimi vijues do të përdoret: <u>Zona 0</u> Pjesët e brendshme të kompartimenteve (dhomave) të cisternës, pajisjet për mbushje dhe zbrazje (shkarkim) dhe linja e tubacioneve të rigjenerimit të avujve. <u>Zona 1</u> Pjesët e brendshme të kabineteve së mbrojtjes të pajisjeve që përdoren për mbushjen dhe shkarkimin dhe brenda të paktën 0,5 m nga pajisja e ajrimit dhe valvulave të sigurisë për shkarkimin e presionit. Pajisjet elektrike në automjetet FL, të vendosura në zonat ku ambienti eksploziv është ose parashikohet të jetë i pranishëm në sasi të tilla që kërkojnë masa paraprake të veçanta, duhet të jenë të përshtatshme për përdorim në një zonë të rrezikshme.	H		



		Pajisje të tilla duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të IEC 60079 pjesët 0 dhe 14 dhe kërkesat shtesë të zbatueshme nga IEC 60079 pjesët 1,2,5,6,7,11 ose 18 ¹¹ . Gjithashtu duhet të plotësohen kërkesat për aparatet elektrike të grupit përkatës dhe klasës së temperaturës në përputhje me lëndët që do të transportohen.			
J22	9.7.8.3	Pajisja elektrike me tension të ulët të përhershme, që përfshin kabllot, të cilat ndodhen jashtë Zonës 0 dhe 1 plotësojnë kërkesat për Zonën 1 për pajisjen elektrike në përgjithësi ose të plotësojnë kërkesat për Zonën 2 në përputhje me IEC 60079, pjesa 14 për pajisjen elektrike të vendosura në kabinën e drejtuesit të mjetit. Kërkesat për grupin e aparaturave elektrike do të plotësohen në përputhje me substancat e mbartura.	H		

Instruksione:

* Datat e aplikimit janë ato që figurojnë tek tabela 9.2.1 të ADR.

Në certifikatë apo në raport duhet të figurojë efikasiteti i pajisjes së frenimit rezistent.

A. Në inspektimet fillestare nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet të sillen certifikata (dëshmia) e prodhuesit të automjetit apo e përfaqësuesit të tij të autorizuar. Në inspektimet periodike, mjaftohet me aktgjykimin e Organizmit të Inspektimit që inspekton automjetin.

B. Nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, mjafton të paraqitet certifikata e prodhuesit të automjetit apo tek aktgjykimin i trupës së inspektimit që inspekton automjetin.

C. Në inspektimet fillestare nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet të sillen qoftë nga titullari i automjetit, qoftë nga prodhuesi i automjetit, certifikata e një përfaqësuesit të tij të autorizuar. Në inspektimet periodike, kur qarqet elektrike kanë pësuar modifikime, do të sillen një certifikatë e servisit elektrik, në të cilën certifikohen që qarqet elektrike përmbushin normën 9.2.2.5 të ADR dhe në të cilën shënohet numri i regjistrimit në Regjistrin e Veçantë të Serviseve për Riparime Automjesh, bashkë me relacionin e një përfaqësuesi të autorizuar mbi përshtatjen e modifikimit me normën.

D. Nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, verifikoni nëse automjeti ka librezën (kartelën) e inspektimit të mjetit, e nëse ka kaluar të gjitha inspektimet e nevojshme teknike.

E. Në inspektimet fillestare nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet të sillen nga prodhuesi i automjetit një certifikatë ku tregohet rubrika (fjalëkalimi) e homologimit (miratimit) të sistemit të frenimit apo numri i raportit pozitiv të Laboratorit Zyrtar të Sistemit të Frenimit. Në inspektimet periodike mjafton të përmbushet kriteri i Trupës së (Organit) Inspektimit që inspekton (kontrollon) automjetin.

a) Miratimi i automjetit sipas Direktivës 98/91/EC apo UN / ECE Rregullorja 105 apo raport i favorshëm Laborator zyrtar në të cilën mospërputhjet janë vlerësuar me këtë direktivë ose rregullore, autorizim paraprak Drejtoria kompetent i Ministrisë së Industrisë, Turizmit dhe Tregtisë.

b) Certifikimi i prodhuesit të automjeteve ku regjistrimi kategorinë pajisje ABS dhe, nëse është e aplikueshme, ngadalëson ose pajisja frenimit të motorit i përmbush kërkesat e tipit IIA.

c) Vërtetimi i një pike të miratimit laboratorike frenimit duke deklaruar kategorinë e pajisje ABS dhe, kur është e përshtatshme, ngadalëson ose pajisja frenimit të motorit plotëson kërkesat e tipit IIA, edhe burim ose si rezultat i reformave të mëdha. Kontributi i ndonjë nga dokumentet e mësipërme do të bëhet në inspektimin e parë e kryer nga 1 Dhjetor 2009 dhe do të shërbejë për lëshimin ose rinovimin e një certifikate të miratimit të automjetit ADR EX / III, AT, FL dhe dem i vlefshëm pas 31-12-2009.

Një automjet nuk tregon ndonjë nga dokumentet e mësipërme nuk do të lëshohet me ta ose rinovo një certifikatë miratimi i vlefshëm ADR pas 31-12-2009.

¹¹ Në mënyrë alternative, mund të përdoren kërkesat e përgjithshme të EN 50014 dhe kërkesat shtesë të EN 50015, 50016, 50017, 50018, 50019, 50020 ose 50028.



F. Në inspektimet fillestare nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet të sillet një certifikatë e lëshuar nga një Laborator i akredituar për provat e rezistencës ndaj zjarrit. Kjo certifikatë mund të zëvendësohet nga certifikata e prodhuesit, e cila duhet të përmbajë numrat e certifikatave të Laboratorëve të akredituar në fushën e provave të rezistencës ndaj zjarrit. Në inspektimet periodike, mjafton kriteri i trupës së (Organit) inspektimit që inspekton automjetin.

G. Nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet verifikuar në librezën (kartelën) e Inspektimit Teknik të Automjetit nëse ky punon me naftë.

H. Në kontrollet (inspektimet) fillestare, duhet të paraqitet nga pronari i automjetit ose nga prodhuesi i automjetit të plotë apo të plotësuar një certifikatë nga përfaqësuesi i tij i autorizuar. Në inspektimet (kontrollet) periodike, nëse janë realizuar modifikime në këto qarqe, do të paraqitet një certifikatë e lëshuar nga një servis i specializuar në fushën e ndërhyrjeve elektrike, certifikatë që do të vërtetojë se qarqet elektrike përmbushin normën 9.2.2.5. të ADR. Në këtë certifikatë duhet të shënohet gjithashtu numri i regjistrimit në Regjistrin e Veçantë (Specifik) të Serviseve për Riparim Automjetesh, e duhet paraqitur, së bashku me të, një raport i një përfaqësuesi të autorizuar nga prodhuesi në përshtatjen e ndërhyrjes (modifikimit) me rregullat në fuqi.

I. Në inspektimet fillestare, duhet të paraqitet një certifikatë e një përfaqësuesi të autorizuar. Në inspektimet periodike, do të mjaftojë kriteri i Trupës së (Organit) Inspektimit që inspekton automjetin.

J. (Pa përmbajtje).

K. Duhet të paraqitet certifikata e prodhuesit për automjetin e plotë apo të plotësuar.

L. Tek vetë automjeti do të verifikohet ekzistenca e markës së homologimit (miratimi) sipas Rregullores ECE 111. Nëse nuk ekziston apo nuk gjendet, prodhuesi i automjetit duhet të paraqesë certifikatën e homologimit (miratimit) apo një raport H i një laboratorit të specifikuar (përcaktuar) për provat e Rregullores ECE 111.

M. Nëse norma nuk është e përfshirë në homologimin (miratimin) ADR, duhet verifikuar në kartelën e Inspektimit (Kontrollit) Teknik të Automjetit nëse motori punon me benzinë. Në rast se po, është e mjaftueshme me kriterin e Trupës së Inspektimit që inspekton automjetin.

N. Është e mjaftueshme me kriterin e Trupës së Inspektimit që inspekton (kontrollon) automjetin.



Aneksi 13

Mjetet ADR duhet t'i nënshtrohen kontrollit teknik vjetor dhe kontrollit teknik ADR. Për kontrollin teknik të mjeteve mbi 3500 kg pesha e mjetit të mallrave të rrezikshme (PMMRR) është kontrolli standard, i cili kryhet në QKT. **Certifikata e Kontrollit Teknik (CKT)** është kusht paraprak për inspektimin teknik ADR.

Përveç kësaj, për ADR, artikujt e mëposhtëm kontrollohen

Nr.	PJESËT QË INSPEKTOHEN	EX/II	EX/III	AT	FL	OX
1	Kontrolli i dokumentacionit të Cisternave			X	X	X
2	Deklaratat	X	X	X	X	X
3	Pajisjet elektrike		X			
4	Lidhjet elektrike		X	X	X	X
5	Kabllo elektrike		X	X	X	X
6	Çelësi kryesor i baterisë		X		X	
7	Bateritë	X	X		X	
8	Qarqet me energji të vazhdueshme		X		X	
9	Instalimi elektrik në pjesën e pasme të kabinës		X		X	
10	Sistemi i frenimit anti-blokalazh (anti-lock)		X	X	X	X
11	Sistemi i frenimit rezistent (endurance)		X	X	X	X
12	Pajisjet e frenimit emergjent për rimorkiot	X	X			
13	Kabina e mjetit	X	X			X
14	Depozitat e karburantit	X	X		X	X
15	Motori	X	X		X	X
16	Sistemi i emetimit të gazrave	X	X		X	
17	Ngruhja me djegie	X	X	X	X	X
18	Pajisja e kufizimit të shpejtësisë	X	X	X	X	X
19	Pajisja e bashkimit (kanxhë) të rimorkiove	X	X			
20	Ndriçimi		X			
21	Karroceria dhe dyert (body çork)	X	X			
22	Pajisja e mbrojtjes së pjesës së pasme (rear protection)			X	X	X
23	Ekrani mbrojtës i kabinës dhe i dritareve					X
24						
25						

Aneksi 14
Format A4

Logo e Ministrisë

KËRKESË

I nderuar Z. Ministër,

Nëpërmjet kësaj kërkesë konfirmojë interesat e mia për t'u licencuar si Qendër për Inspektimin e disa mjeteve në transportin e mallrave të rrezikshme (ADR), të paraqitura në formularin e aplikimit.

Bashkëlidhur formulari i aplikimit, dosja me dokumentet e nevojshme .

Juaj i sinqerisht,

.....
(EMRI, MBIEMRI, NËNSHKRIMI, DATA)



Logo e Ministrisë

APLIKIMI PËR LICENCIMIN SI QENDËR INSPEKTIMI PËR INSPEKTIMIN E MJETEVE ADR

Plotësohet nga Aplikanti (personi fizik/ titullari/ administratori/ pronari) me shkronja të mëdha e me bojë të zezë.

1. Unë / Ne: aplikoj për përfitimin e licencës si qendër inspektimi për mjetet ADR

2. Emri(at) dhe adresa e aplikantit(ve) (përfshirë emrin(at) e plotë, emrin tregtar, adresën e plote postale.

Emri(at) e Aplikantit: _____

Adresa e plote: _____

Telefon Nr. _____

Fax Nr _____

Adresa e e-mail: _____

3. a. Forma juridike e firmës ose organit

p.sh. Person fizik, kompani me përgjegjësi të kufizuar, ent

b. Nëqoftëse është kompani, Nr. e Regjistrimit _____

4. Emrin e plotë të personit të vetëm, i çdo partner ose i çdo drejtor (përdor fletë shtesë nëse nevojitet)

<i>Emri i Plote</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Data e Lindjes</i>

5. Emri dhe Adresa e qendrës së inspektimit, e cila është propozuar për të kryer inspektimin e mjeteve ADR.

Emri: _____

Adresa: _____



Telefon Nr. _____

Fax nr. _____

E-mail adres _____

Emri i administratori/drejtuesi teknik të autorizuar _____

6. Natyra e biznesit ose ndërmarrjes p.sh. Prodhues Mjetesh/ Transportues, Trupë pjesëmarrëse në projektin, etj _____

7. Orët gjate javës normale të punës, ne te cilën qendra do të jetë e hapur për drejtimin e bizneseve sipas termave të kërkuara për Miratim.

<i>Ditët</i>	<i>Orët</i>	<i>Ditët</i>	<i>Orët</i>
Hënë	nga ____ deri ____	Premte	nga ____ deri ____
Marte	nga ____ deri ____	Shtune	nga ____ deri ____
Merk.	nga ____ deri ____	Diel	nga ____
____ deri ____			
Enjte	nga ____ deri ____		

8. Elemente të dispozitës për “Trajnim dhe Mbështetje Teknike”.

(Mund të pajiset me informacion shtesë në fletë të ndara, dhe ti bashkëlidhen këtij aplikimi)

Organi i Trajnimit

Emri i

Organizmit/ shoqërisë: _____

Adresa: _____

Telefon nr. _____

9. Unë/ Ne mbyllim me këtë aplikim dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

- | | | |
|---|-----------------------------|-----------------------------|
| a) Planimetri e vendndodhjes së godinës dhe hapësira e përgjithshme | Po ☐ | Jo ☐ |
| b) Dimensionet e pjesës së ndërtesës për inspektim | Po ☐ | Jo ☐ |
| c) Dokumentet për përdorimin e ndërtesës | Po ☐ | Jo ☐ |
| d) Deklarate e dënimit/ mos dënimit të secilit person | Po ☐ | Jo ☐ |
| e) Evidencën për gjendjen e përshtatshme financiare | Po ☐ | Jo ☐ |
| f) Një kopje të marrëveshjes së ortakërisë (nëse ka) | Po ☐ | Jo ☐ |
| g) Evidencat mbështetëse për të treguar mbështetjen teknike/trajnimet | Po ☐ | Jo ☐ |
| h) Një kopje të regjistrimit tregtar QKR | Po ☐ | Jo ☐ |



Logo e Ministrisë
Logo e Ministrisë

Aneksi 15
Format A4

DEKLARATË

Unë deklaroj që informacioni i dhënë në formularin e aplikimit për miratim si trupë inspektuese është i vërtetë.

Unë jam dakord për të qenë i lidhur me plotësimin e kushteve të vendosura në udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. __, datë ____ *“Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR dhe kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifën e shërbimit”*, të përshtatshme për inspektimin e mjeteve ADR për të cilën unë kam aplikuar, në përputhje me nenin 37 të ligjit nr.118.2012, datë 13.12.2012 “Për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme” dhe Pjesën 9, të aneksit B, të Marrëveshjes Europiane “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit”

Firma e Aplikantit _____ datë _____

Emri _____

Pozicioni _____ Për dhe në emër të _____

(Titullari, partner ose drejtori i kompanisë)



Logo e Ministrisë

Aneksi 16
Faqja e parë
fusha ngjyrë blu e lehtë
formati A4,
letër celulozë,
Pesha 100 gr. ose më shumë

ANEKSI 2¹
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

LICENCË NR:.....

PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI TRUPË INSPEKTIMI E MJETEVE QË KRYEJNË
TRANSPORT TË DISA MALLRAVE TË RREZIKSHME

Zotëruesi i kësaj licence²: _____

Është autorizuar për kryerjen e veprimtarisë si qendër inspektimi e mjeteve që kryejnë transport të disa mallrave të rrezikshme sipas kushteve të vendosura në Pjesën 9, të ligjit nr.9272, datë 16.09.2004 *“Për adehimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane “Për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit”, të ligjit nr.118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” dhe* Kreut IV, të Udhëzimit nr _____, datë _____, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës *“Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjetit ADR dhe tarifën e shërbimit.”*

Licenca lëshohet në përputhje me nenin 37, të ligjit nr.118/2012, datë 13.12.2012 *“Për transportin e mallrave të rrezikshme”*.

Licenca është e vlefshme nga: _____ deri më: _____

Lëshuar në _____, më _____

Firma dhe vula e autoritetit përgjegjës: _____

¹ Ky dokument përbëhet nga një hologramë si elementë sigurie

² Emri i plotë ose emri tregtar dhe adresa e plotë e institutit të trajnimit.



Dispozita të përgjithshme

1. Licenca lëshohet në zbatim të ligjit Nr. 118/2012, datë 13.12.2012.
2. Licenca lëshohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.
3. Licenca është personale dhe e pa-transferueshme.
4. Licenca mund të hiqet nga autoriteti përgjegjës që e ka lëshuar, kur Trupa e Inspektimit përsërit shkeljet:
 - a) e kushteve të vendosura e vendosura në nenin 37, të ligjit Nr. 118/2014, datë 13.12.2014,
 - ose
 - b) nuk plotëson në vazhdimësi kriteret e vendosura në Kreun IV, të Udhëzimit Nr. _____, datë _____;

Dorëzimi i licencës në institucionin, që e ka lëshuar, bëhet brenda 7 ditëve, mbas ditës në të cilën përfundimi i vlefshmërisë ose heqja ka hyrë në fuqi.

Autoritetet Përgjegjëse

Autoritet që janë vendosur në tabelën e mëposhtme janë caktuar për të qenë autoritet e përmendura nga ose në ligjin nr.118/2012, datë 13.12.2012, dhe funksionet që kryejnë prej tyre janë:

Autoriteti	Përgjegjësia
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	Inspektimi teknik (kontrollin e dokumentacionit + kontrollin teknik ADR) i mjeteve, vëzhgimin e qendrave të inspektimit
Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	Akreditimi i trupave inspektuese për enët e transportueshme nën presion (cisternat)
Ministria e Brendshme	Çështjet që lidhen me sigurinë rrugore në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme dhe në mënyrë të veçantë trajton transportin e Lëndëve Plasëse (substancave eksplozive).
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet	Çështjet që lidhen me transportin rrugor të substancave radioaktive.
Agjencia Kombëtare Bërthamore	Çështjet që lidhen me transportin rrugor të materialeve bërthamore.
Autoriteti Rrugor Shqiptar	Çështjet që lidhen me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme përmes tuneleve: Tuneli i Thirrës Tuneli Kërrabës
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Të gjithë funksionet e tjera që përfshinë transportin e mallrave të rrezikshme trajnimin e këshilltarëve të sigurisë, drejtuesit e mjeteve dhe punonjësit pjesëmarrës në transport Lëshimi i licencës për trupat e inspektimit të mjeteve ADR
Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	Lëshimi i miratimit të trupave të inspektimit të enëve nën-presion të transportueshme (cisternave)



SHTOJCA II

Aneksi I

Mallrat e rrezikshme që mbarten në tipat e mëposhtme të mjeteve të miratuara ADR

Tipi i mjetit ADR	Përshkrimi i mallrave që transportohen
EX/II, EX/III	Substancat dhe artikujt Eksplozivë (klasa 1)
FL	Lëngjet që kanë një pikë ndezje që nuk kalon 60° C (me përjashtim për dieselin, gazoilin dhe vajin që nxehet lehtë) në cisternat fikse ose të çmontueshme me kapacitet > 1m³ ose në kontejnerët cisternë/cisternat e lëvizshme me kapacitet > 3m³. Gazet e ndezshëm në cisternat fikse ose të çmontueshme me kapacitet > 1m³ ose në kontejnerët cisternë/cisternat e lëvizshme ose KGESH (MEGS) me kapacitet > 3m³. Një mjet-bateri me kapacitet të përgjithshëm me kapacitet > 1m³ për gazet e ndezshëm.
OX	Peroksidin e hidrogjenit në cisternat fikse ose të çmontueshme me kapacitet > 1m ³ ose në kontejnerët cisternë/cisternat e lëvizshme me kapacitet > 3m ³ .
AT	Mjetet e tjera përveç EX/III, FL, ose OX të destinuara për transportin e mallrave të rrezikshme në cisternat fikse ose të çmontueshme me kapacitet > 1m³ ose në kontejnerët cisternë/cisternat e lëvizshme ose KGESH (MEGS) me kapacitet > 3m³. Një mjet-bateri me kapacitet të përgjithshëm me kapacitet > 1m³ përveç mjetit FL.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 504 lekë